



**Programet e BE-së
për Organizatat e
Shoqërisë Civile**



Programet e BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile

Raport i Hulumtimit
Nëntor 2018



Botuar nga KCSF dhe
përgaditur nga:

Autor: Edis Agani

Kontribuan:
Bardha Tahiri

Ky publikim është përkrahur financiarisht nga Sida.

Përmbajtja e këtij publikimi është në tërësi përgjegjësi
e autorëve dhe nuk reflekton domosdomërisht
qëndrimet e Sida-s.

Të drejtat e rezervuara © 2018. Fondacioni Kosovar
për Shoqëri Civile (KCSF) Nëntor 2018

Përmbledhje Ekzekutive.....	5
HYRJE	6
1. Përshkrimi i problemit	7
1.1 Sfondi	7
1.2 Kosova dhe raportet e saja me Programet e BE-së	8
1.3 Gjendja aktuale	10
2. Analiza	12
2.1 Hartëzimi i të gjitha programeve të BE-së	12
2.2 Informacion i përgjithshëm mbi procedurën e aplikimit dhe kriteret	30
2.3 Kosova në Programet e BE-së	32
2.4 Studime të rasteve - me pjesëmarrjen e organizatave të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë ato të Kosovës	36
3. Të gjeturat e hulumtimit në terren	39
3.1 Niveli i njohurive për programet e BE-së në përgjithësi dhe ato që janë të lejuara për Ballkanin Perëndimor në veçanti	39
3.2 Niveli i njohurive (informimit) për 17 Programet e BE-së për të cilat Kosova kualifikohet që nga viti 2017	39
3.3 Kontaktet me organizatat me seli në BE me qëllim të pjesëmarrjes në këto programe	40
3.4 Niveli i njohurive për procedurën e nevojshme për të aplikuar në këto programe	40
3.5 Ndarja e informacionit / promovimi i programeve të BE-së nga BE dhe Ministria e Integritimit Europian	41
4. Konkluzionet dhe rekomandimet	42
4.1 Mungesa e njohurive për programet e BE-së	42
4.1.1 Konkluzionet	42
4.1.2 Rekomandimet	42
a) Ndarja e informacionit nga BE dhe institucionet qeveritare	42
b) Roli avokues i OJQ-ve	42
4.2 Mundësitë dhe sfidat për qasje në programet e BE-së	43
4.2.1 Konkluzionet	43
4.2.2 Rekomandimet	44
4.3 Përkrahja/ngritja e kapaciteteve për OShC-të për të lehtësuar qasjen në programet e BE-së	44
4.3.1 Konkluzionet	44
4.3.2 Rekomandimet	45
a) Programi i ngritjes së kapaciteteve që lidhet me fushën e veprimit	45
b) Udhëzimi-mentorimi (“coaching”) dhe shembujt e praktikës së mirë - të mësuarit nga përvoja reale	45
c) Procesi lidhur me programet e ngritjes së kapaciteteve	46
d) Përdorimi më i mirë i qendrave të informacionit- Resource Center	46
5. Burimet dhe bibliografia	47

Përmbledhje Ekzekutive

Programet e BE-së janë programe shumë-vjeçare të dedikuara për zbatimin e politikave të veçanta të BE-së, me objektiva dhe buxhet të mirë-përcaktuara. Këto programe synojnë sektorë dhe përfitues specifik që mund të jenë institucione qeveritare, institucione profesionale/të specializuara/hulumtuese dhe organizata joqeveritare. Drejtoritë e Përgjithshme të ndryshme të Komisionit European janë përgjegjëse për zbatimin e programeve individuale të BE-së sipas fushëveprimit të tyre.

Secila prej Programeve të BE-së synon të promovojë/mbështesë politikat e BE-së dhe të forcojë bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare të BE-së (dhe anëtarëve të tjerë siç janë vendet në anëtarësim dhe para anëtarësimit) në fusha të caktuara siç janë hulumtimi & inovacioni, arsimi, kultura, shëndeti, mbrojtja e mjedisit, dogana dhe taksat, drejtësia, etj.

Marrëveshja Kornizë (MK) në mes të Kosovës dhe Komisionit European mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrje në Programet e BE-së është nënshkruar më 25 nëntor 2016. MK përfshin një listë prej 17 programeve të BE-së në të cilat Kosova ka të drejtë të pjesëmarrjes. Gjatë viteve 2017 dhe 2018 Kosova i ka dhënë përparësi katër programeve të BE-së për të cilat janë nënshkruar marrëveshjet ndërkombëtare me BE-në. Këto marrëveshje janë ratifikuar deri në shtator të vitit 2018, në përputhje me kërkesat legjislative të Kosovës. Kjo do të mundësojë që OShC-të e Kosovës të aplikojnë edhe si organizata udhëheqëse në thirrjet e ndryshme për propozime të shpallura në kuadër të këtyre programeve. Mundësia e parë është programi 'BE për Qytetarët' me thirrjen për propozime në fund të vitit 2018.

Hulumtimi synon hartëzimin e të gjitha 17 programeve dhe theksimin e rëndësisë së tyre për OShC-të në përgjithësi dhe OShC-të e Kosovës në veçanti. Për më tepër, hulumtimi fokusohet në mënyrë specifike në katër programet e BE-së për të cilat janë nënshkruar MN-të dhe ofron informacione të mëtejshme mbi avantazhet dhe sfidat për OShC-të e Kosovës në lidhje me këto programe.

Përmes intervistave dhe studimeve të rasteve, hulumtimi synon të trajtojë përparësitë dhe sfidat kryesore për OShC-të gjatë aplikimit dhe zbatimit të programeve të BE-së. Përfundimisht, hulumtimi jep konkluzione dhe rekomandime në lidhje me nivelin e njohurive për programet e BE-së në mesin e OShC-ve të Kosovës, nevojën për përkrahje qoftë nga institucionet qeveritare, donatorët ose përmes programeve të synuara dhe të përshtatura për ngritjen e kapaciteteve.

Vlen të përmendet se hulumtimi është realizuar dhe raporti është hartuar në fund të muajit gusht 2018, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet janë dhënë për këtë afat kohor të hulumtimit.

HYRJE

Komisioni European (KE) në sferën e tij të bashkëpunimit dhe zhvillimit ndërkombëtar ka treguar se shoqëria civile ka një rol të madh në ndërtimin e sistemeve demokratike duke kontribuar në zhvillimin e politikave efektive, zhvillimin e drejtë dhe të qëndrueshëm dhe rritjen gjithëpërfshirëse. Në këtë mënyrë, nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve do të përfaqësohen më mirë dhe do të merren parasysh. Prandaj, KE bën thirrje për forcimin e "lidhjeve me organizatat e shoqërisë civile, partnerët socialë dhe autoritetet lokale, përmes dialogut të rregullt dhe përdorimit të praktikave më të mira", në veçanti për të "mbështetur shfaqjen e shoqërisë civile lokale që në mënyrë efektive mund të kontribuojë në dialogun me autoritetet publike dhe të mbikëqyr punën e tyre"¹.

Ky rol i shoqërisë civile është paraparë edhe në programet e BE-së. Një numër i programeve të BE-së (ku disa prej tyre janë edhe 'BE për Qytetarët', 'Kultura për Europën' dhe Erasmus +) kanë prioritet dhe komponenta specifike që kryesisht synojnë organizatat e shoqërisë civile dhe promovojnë rolin e tyre në ndërtimin dhe forcimin e shoqërive demokratike.

Meqë Kosova ka shprehur interesim për programet Europa për Qytetarët, Erasmus +, COSME dhe Europa Krijuese në mesin e listës prej gjithsej 17 programe në dispozicion sipas Marrëveshjes Kornizë të nënshkruar midis Bashkimit European dhe Kosovës² dhe meqë KCSF vazhdon të mbështesë OShC-të e Kosovës në kontributin e tyre në procesin e përgjithshëm të integritimit european, është identifikuar nevoja për një studim për të hartëzuar të gjitha 17 programet e BE-së dhe mundësinë e qasjes së OShC-ve në ato. Ky studim ka për synim:

- Të elaboron dhe të japë informacion mbi Programet e BE-së të cilat janë të dedikuara për të mirën e OShC-ve.
- Ofrimin e informacionit mbi kapacitetet e OShC-ve në Kosovë për të marr fondet e këtyre programeve
- Ofrimi i inputeve për KCSF-në për të hartuar programe të posaçme të trajnimit që do të adresonin nevojat e OShC-ve sa i përket qasjes dhe absorbimit të programeve të BE-së
- Ofrimi i inputeve për aktivitetet e ardhshme të avokimit për aplikim për programet tjera të BE-së ku OShC-të e Kosovës kanë kapacitete dhe i plotësojnë kushtet që të aplikojnë.

Për më tepër, ky studim do të synojë informimin më të mirë të OShC-ve të Kosovës mbi programet e BE-së, si mund të arrihen dhe të zbatohen ato. Informatat nga praktikat më të mira nga rajoni do të jepen si shembuj konkret. Duke e pasur parasysh se Kosova është prapa vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor sa i përket përfitimit nga programet e BE-së, praktikat rajonale mund të shërbejnë si një udhërrëfyes i mirë për ecjen përpara. Në fund, do të ofrohen propozime për ecjen përpara, për hapat e ardhshëm sa i përket avokimit dhe ngritjes së kapaciteteve për të avancuar mundësinë e OShC-ve të Kosovës që të përfitojnë nga këto fonde.

Metodologjia e hulumtimit përfshin hulumtimin e literaturës dhe intervistat me OShC-të kombëtare dhe lokale në tërë Kosovën. Akterët e tjerë relevantë gjithashtu janë të intervistuar për nevojat e këtij hulumtimi.

Edhe pse hulumtimi, përmes intervistave, ka përfshirë një numër të OShC-ve (gjithsej tetë), kjo mostër mund të shihet si faktor kufizues i hulumtimit. Për më tepër, meqenëse programet e BE-së shpesh kërkojnë partneritete me palët e tjera të interesit, siç janë institucionet qeveritare ose universitetet, ky aspekt do të mund të merrej parasysh kur të realizohen hulumtime në lidhje me këto programe. Meqë ky nuk është rasti me këtë hulumtim, kjo mund të konsiderohet si një faktor tjetër kufizues.

¹ https://ec.europa.eu/europeaid/sectors/human-rights-and-governance/civil-society_en

² MARRËVESHJA KORNIZË ndërmjet Bashkimit European dhe Kosovës mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së

1. Përshkrimi i problemit

1.1 Sfondi

Në fund të vitit 2013, Parlamenti Europian dhe Këshilli i Bashkimit Europian arritën një marrëveshje për buxhetin e BE-së për periudhën e ardhshme programore shtatë vjeçare (2014-2020). Një pjesë e konsiderueshme e këtij plani të ri buxhetor, me një shumë totale prej 960 miliardë eurosh, do të përdoret për instrumentet, programet dhe iniciativat e financimit të BE-së. Brenda kësaj shume përfshihet edhe financimi i ndarë për *Programet e BE-së* për periudhën 2014-2020, pjesa më e madhe e të cilës është vazhdim i programeve të zbatuara më parë gjatë periudhës 2007-2013.

Programet e BE-së janë programe shumë-vjeçare të dedikuara për zbatimin e politikave të veçanta të BE-së, me objektiva dhe buxhet të mirë-përcaktuar. Këto programe synojnë sektorë dhe përfitues specifik që mund të jenë institucione qeveritare, institucione profesionale/të specializuara/hulumtuese dhe organizata joqeveritare. Drejtoritë e Përgjithshme të ndryshme të Komisionit Europian janë përgjegjëse për zbatimin e programeve individuale të BE-së sipas fushëveprimit të tyre.

Secila prej Programeve të BE-së synon të promovojë/mbështesë politikat e BE-së dhe të forcojë bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare të BE-së (dhe anëtarëve të tjerë siç janë vendet në anëtarësim dhe para anëtarësimit) në fusha të caktuara siç janë hulumtimi dhe inovacioni, arsimiti, kultura, shëndeti, mbrojtja e mjedisit, dogana dhe taksat/tatimet, drejtësia, etj.

Fillimisht Programet e BE-së (ish-Programet e Komunitetit) u hartuan vetëm për vendet Shtete Anëtare të BE-së, por në vitin 2003 gjatë takimit të Këshillit Europian në Selanik, u vendos që Programet e Bashkimit Europian të hapen edhe për vendet jo-anëtare të BE-së dhe ZEE-së, të cilat ishin në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit. Qëllimi i pjesëmarrjes së vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale është të lehtësojë pranimin e tyre në BE, si dhe t'i familjarizoj ato me metodat dhe politikat e BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në programet, agjencitë dhe komitetet e BE-së është të ndihmohen vendet e zgjerimit që të njihen me politikat dhe instrumentet e BE-së dhe të rrisin bashkëpunimin para anëtarësimit. E drejta e pjesëmarrjes është vendosur nga Këshilli Europian, për vendet kandidatë në dhjetor të vitit 1997 dhe për vendet e Ballkanit Perëndimor në 2003. Mundësia e pjesëmarrjes vendoset rast pas rasti për secilin program, agjenci dhe komitet. Në vitin e parë të pjesëmarrjes, vendet kandidatë dhe vendet kandidatë potenciale mund të kërkojnë bashkëfinancim përmes IPA-s deri në 90% të kontributit të vendit në një program të BE-së.

Vendet kandidatë dhe vendet kandidatë potenciale mund të marrin pjesë në programet e BE-së duke nënshkruar Marrëveshjen Kornizë ndërmjet Qeverisë dhe shërbimit të KE-së. Marrëveshja Kornizë përcakton parimet e përgjithshme dhe rregullat për pjesëmarrje në Programet e BE-së. Hapi tjetër është që Qeveria duhet të shprehë interesimin (bazuar në nevojat dhe prioritetet kombëtare) për pjesëmarrje në programe të veçanta të BE-së me kushtin që i posedon kapacitetet administrative dhe absorbuese. Pasi që KE të pajtohet me programet e propozuara, një marrëveshje ndërkombëtare nënshkruhet midis KE-së dhe Qeverisë për programet specifike të BE-së. Vendet që nuk janë Shtete Anëtare të BE-së gjithashtu obligohen të paguajnë një tarifë (biletë hyrëse) për pjesëmarrje në Programet e BE-së. Tarifat janë të ndryshme për programet e ndryshme dhe vendet e ndryshme, pasi që secili program ka rregullat e veta për pjesëmarrje. Disa nga Programet e BE-së kanë nën-programe, kështu që Shtetet jo-anëtare të BE-së që kualifikohen mund të vendosin për pjesëmarrje për një pjesë të veçantë të programit dhe jo për Programin si tërësi (kjo gjithashtu është çështje e negociatave me Komisionin Europian).

1.2 Kosova dhe raportet e saja me Programet e BE-së

Që nga prilli i vitit 2005 Komisioni European është përkushtuar të mbështesë Kosovën në rrugën e saj Europiane. Ky angazhim është pranuar me miratimin e Komunikatës së Këshillit “E ardhmja Europiane për Kosovën”, me qëllim të mbështetjes së procesit të stabilizimit dhe asociimit. Më 17 shkurt 2008 Parlamenti i Kosovës e ratifikoi deklaratën e Kosovës për pavarësi nga Serbia. Në dhjetor të vitit 2009, Komisionit European iu kërkua nga Këshilli që të mbështesë më tej progresin e Kosovës drejt BE-së në përputhje me perspektivën europiane të rajonit dhe përkundër çështjeve të tjera t’ia hapë Kosovës mundësinë për pjesëmarrje në Programet e BE-së.

Procesi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Kosovës dhe BE-së filloi në tetor të vitit 2013. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit u nënshkrua në tetor të vitit 2015 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2016. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Kosova hyri për herë të parë në një marrëveshje kontraktuale me BE-në, për çka është zotuar të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja (përafrimi i legjislacionit, çështjet tregtare etj.).

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në përmbushjen e përgjegjësiave që rrjedhin nga MSA, Qeveria e Kosovës vendosi të shfrytëzojë mundësinë për të marrë pjesë në Programet e BE-së me qëllim të ngritjes së mëtejshme të kapaciteteve teknike dhe administrative në përputhje me standardet e BE-së. Pas vendimeve të Parlamentit European dhe Këshillit, Kosova mund të marr pjesë në Programet e BE-së. Marrëveshja Kornizë (MK) përfshin (shtojca 1) listën e 17 Programeve të BE-së në të cilat Kosova ka të drejtë të marr pjesë.

Më poshtë është dhënë përmbledhja e datave kryesore relevante për Kosovën dhe raportet e saja me programet e BE-së:

- Vendet potenciale kandidate kualifikohen për të marr pjesë në programet e BE që nga takimi i Këshillit European në Selanik në vitin 2003.
- Më 20 prill 2005, KE miratoi Komunikatën për Kosovën drejtuar Këshillit “E ardhmja Europiane për Kosovën” e cila përforcoi përkushtimin e Komisionit për të mbështetur Kosovën në procesin e integritimit në BE.
- Deklarata e Republikës së Kosovës për pavarësinë nga Serbia u ratifikua më 17 shkurt 2008 nga Parlamenti i Kosovës.
- Më 7 dhjetor 2009, Këshilli mirëpriti Komunikatën e Komisionit European të 14 tetorit 2009 me titull “Kosova - Përmbushja e perspektivës së saj Europiane”. KE-së iu kërkua që të mbështesë më tej progresin e Kosovës drejt BE-së në përputhje me perspektivën europiane të rajonit dhe përkundër çështjeve të tjera t’i jepet mundësia Kosovës për pjesëmarrje në Programet e BE-së.
- Më 22 tetor 2012, Këshilli autorizoi Komisionin European për të hapur negociatat në emër të BE-së për një marrëveshje kornizë me Kosovën në lidhje me pjesëmarrjen e saj në programet e BE-së.
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit u nënshkrua në shkurt të vitit 2016 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2016, duke hapur kështu një perspektivë të re për Kosovën. Me hyrjen në marrëveshje kontraktuale me BE-në, Kosova është zotuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA (përafrimi i legjislacionit, çështjet tregtare etj.)

- Marrëveshja Kornizë (MK) në mes të Kosovës dhe KE-së mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrje në Programet e BE-së u nënshkrua më 25 nëntor 2016. MK përfshin (shtojca 1) listën prej 17 programeve të BE-së në të cilat Kosova i plotëson kushtet për pjesëmarrje. Më poshtë është lista e plotë e programeve që janë pjesë e MK-së.
 - Fiscalis 2020
 - Dogana 2020
 - Hercule III
 - Drejtësia
 - Programi për të drejta, barazi dhe shtetësi
 - Europa për qytetarët
 - Mekanizmi i mbrojtjes civile
 - Zgjidhjet e interoperabilitetit (ndërveprimit) për administratat publike, bizneset dhe qytetarët europianë (ISA 2)
 - COSME
 - Programi për punësim dhe inovacion social (EaSI)
 - Erasmus +
 - Europa Krijuese
 - Horizonti 2020
 - Programi Shëndeti për Rritje
 - Programi i Konsumatorit
 - LIFE
 - Koperniku

Gjatë viteve 2017 dhe 2018 Kosova ka nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshje me BE-në për t'iu bashkangjitur katër (4) programeve të BE-së.

Komisioni Europian u bën thirrje vendeve që arrijnë të kualifikohen për programet e BE-së të kryejnë vlerësimin e plotë të nevojave dhe të caktojnë prioritetet e tyre për aplikim në programet me interes për ato. Pas nënshkrimit të MK-së, Qeveria e Kosovës, nën drejtimin e Ministrisë së Integritetit Europian ka zhvilluar disa punëtori konsultative me grupe të ndryshme interesi: institucionet qeveritare, OShC-të, sektorin privat, institucionet arsimore, etj. me qëllim të përcaktimit të nevojave sektoriale si një hap i parë drejt caktimit të prioritetit të pjesëmarrjes në programet e BE-së. Është kryer vlerësimi paraprak i nevojave për të mbështetur procesin e caktimit të prioritetëve. Vlerësimi i nevojave ka marrë parasysh dokumentet kryesore të politikave siç janë Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Plani i Veprimit i MSA-së, Agjenda Europiane e Reformës dhe politikat e tjera kombëtare. Më poshtë janë dhënë programet e BE-së për të cilat Kosova ka vendosur të hyjë në negociata dhe të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare:

- **Erasmus +** - *përfitues: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*; Erasmus + është programi i BE-së në fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit me qëllim që të kontribuojë në strategjinë e Europës 2020 për rritjen, punësimin, barazinë sociale dhe përfshirjen. Erasmus + gjithashtu synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm të partnerëve të saj në fushën e arsimit të lartë dhe të kontribuojë në arritjen e objektivave të Strategjisë së BE-së për Rininë.
- **COSME** - *përfitues: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*; Programi është themeluar me Rregulloren (EU) Nr. 1288/2013 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 me qëllim të promovimit të ndërmarrësisë dhe përmirësimit të mjedisit afarist për NVM-të.
- **Europa krijuese** - *përfitues: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit* ; Programi është themeluar me Rregulloren (EU) Nr. 1295/2013 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 me qëllim të mbështetjes së iniciativave të sektorit të kulturës dhe audioviziv.
- **Europa për qytetarët** - *përfitues: Ministria e Integritimit Europian*. Programi është themeluar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 390/2014 të datës 14 prill 2014 me qëllimin që të mbështesë: kuptimin e BE-së, historinë dhe diversitetin e saj dhe angazhimin demokratik dhe pjesëmarrjen qytetare.

Duhet të theksohet se nga katër programet e lartpërmendura, tri janë programe të BE-së që kryesisht janë të dizajnuara për organizatat e shoqërisë civile (OShC) dhe i synojnë ato. Në të vërtetë, programet si Europa për Qytetarët ose Europën Krijuese zbatohen pothuajse ekskluzivisht nga OShC-të dhe promovojnë vlerat demokratike europiane, përmes të drejtave të njeriut, demokracisë apo perspektivës kulturore. Caktimi i prioritetit të këtyre programeve të veçanta për Kosovën si grupi i parë i programeve të BE-së me pjesëmarrje aktive të Kosovës, ofron një portë shtesë për OShC-të në Kosovë për të zgjeruar rolin e tyre në procesin e demokratizimit dhe procesin e anëtarësit në BE.

1.3 Gjendja aktuale

Programet e zgjedhura të BE-së janë në përputhje me prioritetet afatshkurtra të Kosovës dhe nevojat e menjëhershme që rrjedhin nga Agjenda e Reformave Europiane dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Përveç kësaj, katër Programet e mësipërme të Bashkimit Europian i japin mundësinë e pjesëmarrjes grupeve të ndryshme të synuara siç janë organet qeveritare, organizatat private dhe organizatat e shoqërisë civile. Duke marrë pjesë në Programet e BE-së, Kosova si edhe shtetet tjera jo anëtare të BE është e detyruar të kontribuojë në buxhetin e BE-së duke paguar një tarifë (biletë hyrëse). Tarifat janë të ndryshme për programet e ndryshme dhe përfituesit e ndryshëm, pasi që secili program ka rregullat e veta për pjesëmarrje. Biletat hyrëse janë negociuar me Komisionin Europian gjatë hartimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare (MN). Nënshkrimi i MN-ve për programin e përzgjedhur (më sipër) të BE-së është realizuar si më poshtë:

- | | |
|--------------------|-----------------|
| - COSME | 19 dhjetor 2017 |
| - Europa Krijuese | 5 qershor 2018 |
| - BE për qytetarët | 26 qershor 2018 |
| - ERASMUS + | 5 qershor 2018 |

Secili nga marrëveshjet, në përputhje me legjislacionin e Kosovës, kërkon ratifikimin nga Parlamenti i Kosovës. Ratifikimi për katër programet e lartpërmendura të BE-së është finalizuar siç tregohet në listën e mëposhtme:

- | | |
|--------------------|-----------------|
| - COSME | 23 qershor 2018 |
| - Europa Krijuese | 20 shtator 2018 |
| - BE për qytetarët | 20 shtator 2018 |
| - ERASMUS + | 20 shtator 2018 |

Meqenëse Qeveria e Kosovës nuk mund të sigurojë fonde të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha kostot e biletave hyrëse për katër Programet e lartpërmendura të BE-së, Komisioni European përmes programit IPA 2017 do të rimbursojë shumën e biletave të hyrjes për katër Programet e BE-së për pjesëmarrje në vitin 2018. Për periudhën 2020-2019, Komisioni European dhe Kosova do të negociojnë në kuadër të IPA 2018 shkallën e rimbursimit dhe do të eksplorojnë mundësinë për pjesëmarrje në programet e tjera të BE-së.

Për më tepër, për pjesëmarrje në Programet e BE-së nevojitet një planifikim i duhur. Qeveria/përfituesit duhet të planifikojnë koston e parapagimeve të hyrjes në buxhetin e tyre afatmesëm dhe kostot e parapagimeve të hyrjes në Programet e BE-së të rimbursuara nga programet e IPA-s duhet të programohen/alokohen paraprakisht (një ose dy vjet më herët). Akterët kryesorë të ndikuar nga ky veprim janë përfituesit përfundimtarë të granteve (organet qeveritare dhe joqeveritare) të Programeve të përzgjedhura të BE-së.

BE e konsideron shoqërinë civile si partnere të besueshme dhe përfituese në të gjitha programet e saja të ndryshme. Kjo është politika që BE tenton të promovojë përtej kufirit të saj të menjëhershëm tek vendet në anëtarësim ose para-anëtarësim. E njëjta qasje përdoret në të gjitha programet e BE-së që janë objekt i këtij hulumtimi. Organizatat e shoqërisë civile kanë të drejtë të marrin pjesë në këto programe si përfitues të drejtpërdrejtë (përmes aplikimit në thirrjet për propozime) ose si palë relevante e interesit apo përfitues jo i drejtpërdrejt (përmes roleve të avokimit). Analiza do të fokusohet në 17 programet e BE-së për të cilat Kosova është kualifikuar. Fokusi i analizës do të jetë mbi përfitimet e mundshme të OShC-ve nga programet. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet katër programeve të BE-së për të cilat janë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare.

2. Analiza

2.1 Hartëzimi i të gjitha programeve të BE-së

Marrëveshja kornizë ndërmjet Bashkimit Europian dhe Kosovës mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së **përfshin** gjithsej 17 Programe të BE-së. Ato janë listuar në seksionin e mëparshëm. Ky studim ka hartëzuar të gjitha 17 Programet e BE-së, objektivat e tyre kryesore dhe përfituesit potencialë. Shumica e programeve bazohen në Rregullore, si bazë e tyre ligjore, ku korniza procedurale është vendosur në aspektin e zbatimit të programit. Hartëzimi gjithashtu përfshin referencën për kualifikimin e OShC-ve për të përfituar nga këto programe. Në shumicën e programeve OShC-të përmenden në Rregullore si përfitues potencial. Disa nga programet madje janë zhvilluar për t'u zbatuar kryesisht nga OShC-të. Për ato programe zbatimi i të cilave është paraparë të kryhet nga institucione të specializuara qeveritare (si Fiscalis, Dogana), gjendet lidhja indirekte me OShC-të dhe kontributin e tyre të mundshëm në program. Për programet me fokus të qartë e të ngushtë (siç është programi i Drejtësisë) është deklaruar se lidhja dhe përfitimi i OShC-ve mund të jetë i natyrës jo të drejtpërdrejtë dhe në sinergji me programet e tjera ku OShC-të janë përfituese të drejtpërdrejta.

Duhet të theksohet se hartëzimi themelor i 17 programeve të BE-së është realizuar në vitin 2017 nga Instrumenti për Përgatitjen e Projekteve i financuar nga BE, si pjesë e vlerësimit paraprak të nevojave që i ka shërbyer Ministrisë së Integritimit Europian për të identifikuar katër programet e BE-së për të cilat Kosova ka nënshkruar Marrëveshjet Ndërkombëtare me BE-në. Kjo analizë është ndërtuar mbi këtë hartëzim duke shtuar aspekte tjera relevante në këtë hulumtim të veçantë dhe për objektivat e tij.

Nga 17 programet e BE-së, 10 janë të dizajnuara për të synuar OShC-të, si përfitues kryesorë ose në mesin e përfituesve të tjerë: organizatave qeveritare, operatorëve të sektorit privat apo palëve të tjera të interesit. Hartëzimi përfshin emrin e programit, objektivat kryesore të tij, nëse programi është me interes për OShC-të, nëse programet janë me interes të veçantë për OShC-të e Kosovës dhe nëse po, cilat do të jenë mundësitë dhe sfidat e pjesëmarrjes në programe të tilla.

Tabela e mëposhtme përfshin hartëzimin e 17 programeve të BE-së dhe elementëve të tjera siç u përmend më lart:

Nr	Programet e BE-së	Objektivat e programeve të BE-së ³	Kush kualifikohet	Përvoja e Rajonit të Ballkanit Perëndimor	Me interes për OShC (P/J)	Me interes për OShC-të Kosovare	Komentet për rëndësinë e programit për OShC-të, duke përfshirë kriteret, sfidat dhe mundësitë
1.	FISCALIS 2020 235 milion euro (2014-2020)	<p>- Dhënia e mundësisë administratave tatimore kombëtare për të krijuar dhe shkëmbyer informacione dhe ekspertizë (përmes punëtorive, trajnimeve, seminareve).</p> <p>- zhvillimi dhe operimi i sistemeve TI trans-europiane të mëdha në partneritet,</p> <p>-Krijimi i rrjeteve të ndryshme 'personi për personin' duke sjellë së bashku zyrtarë kombëtarë nga e gjithë Europa.</p>	<p>Zyrtarët e administratës tatimore (BE dhe vendet kandidate + vendet kandidate potenciale për anëtarësim)</p>	<p>Të gjitha vendet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës, marrin pjesë në program.</p>	<p>JO</p>	<p>Shumë i kufizuar pasi që ky program synon institucionet e specializuara të Qeverisë</p>	<p>Ky është program teknik dhe specifik bashkëpunimi i BE-së i cili u mundëson administratave tatimore kombëtare krijimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës. Si i tillë, përveç administratave tatimore dhe zyrtarëve/ ekspertëve të tyre, mund të përfshijë edhe dhomat e tregtisë në funksion të mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të operatorëve ekonomikë.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>Përvoja rajonale dhe e BE-së nuk tregojnë shumë hapësirë për pjesëmarrjen e OShC-ve në këtë program.</p>

³ Të dhënat janë marrë nga faqet e internetit të çdo programi të BE-së

<p>2.</p>	<p>DOGANA 2020</p> <p>548 milion euro</p> <p>(2014-2020)</p>	<p>Objektivat specifike do të arrihen, në veçanti duke:</p> <p>(a) financuar sistemet TI për të mundësuar zhvillimin e doganave elektronike të plota në Europë.</p> <p>(b) siguruar qasje moderne dhe të harmonizuar për procedurat dhe kontrollet doganore;</p> <p>(c) lehtësuar tregtinë e ligjshme;</p> <p>(d) reduktuar kostot e pajtueshmërisë dhe barrës administrative; dhe</p> <p>(e) përmirësuar funksionimin e autoriteteve doganore.</p>	<p>Zyrtarët e administratës doganore (BE dhe vendet kandidate + vendet kandidate potenciale për anëtarësim)</p>	<p>Të gjitha vendet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës, marrin pjesë në program.</p>	<p>JO</p>	<p>Shumë i kufizuar pasi që ky program synon institucionet e specializuara të Qeverisë</p>	<p>Një nga objektivat specifike të këtij programi është përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve doganore dhe organizatave ndërkombëtare, vendeve të treta, autoriteteve të tjera qeveritare, duke përfshirë autoritetet e BE-së dhe Autoritetet mbikëqyrëse të tregut, si dhe operatorët ekonomik dhe organizatat që përfaqësojnë operatorët ekonomikë. Në këtë kuptim, Dhomat/Odat Ekonomike mund të jenë përfituese të mundshme, partnerë ose palë me interes që mund të kontribuojnë në këtë qëllim.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>Përveç zyrtarëve të doganave dhe zyrtarëve tjerë relevant të administratës publike, operatorët ekonomik kanë një rol vendimtar në këtë program. Oda Ekonomike e Kosovës duhet gjithashtu të përfshihet në aktivitete - në cilindo kapacitet.</p> <p>Përvoja rajonale dhe e BE-së nuk ka treguar shu më hapësirë për pjesëmarrjen e OShC-ve në këtë program.</p>
-----------	---	---	---	---	-----------	--	---

<p>3</p>	<p>COSME</p> <p>2,3 miliardë euro</p>	<p>Programi synon të përmirësoj kushtet kornizë në dobi të aftësisë konkurruese dhe qëndrueshmëriës së Ndërmarrjeve të BE-së</p> <p>duke përfshirë edhe ato në sektorin e turizmit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inkurajimi i kulturës së ndërmarrësisë dhe promovimi i krijimit dhe rritjes së NVM-ve. • Përmirësimi i qasjes në financa për NVM-të në formën e kapitalit dhe borxhit (COSME synon të lehtësojë qasjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në të gjitha fazat e ciklit të tyre të jetës - krijimit, zgjerimit ose transferimit të biznesit. • Përmirësimi i qasjes në tregjet brenda BE-së dhe në nivel global (COSME ndihmon bizneset për të hyrë në tregje në BE dhe më gjerë. Ajo financon Rrjetin e Ndërmarrjeve Europiane që ndihmon NVM-të të gjejnë partnerë të biznesit dhe teknologjisë dhe të kuptojnë legjislacionin e BE-së; portali Biznesi Juaj në Europë që ofron informata praktike për bërjen e biznesit në Europë; dhe Portali për Ndërkombëtarizimin e NVM-ve për kompanitë që duan të zhvillojnë aktivitetet e tyre jashtë Europës). 	<p>Të gjitha vendet e BE-së, vendet e EFTA-s dhe vendet në anëtarësim, vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për anëtarësim.</p> <p>Administrata publike dhe NVM-të</p>	<p>Të gjitha vendet në rajon marrin pjesë në program.</p>	<p>JO</p>	<p>Shumë e kufizuar edhe në rastet e ndërmarrjeve sociale</p>	<p>Ky program synon veçanërisht NVM-të, si dhe administratën publike përgjegjëse për këtë fushë. Sidoqoftë, sa i përket ndërmarrjeve sociale dhe shoqatave të ndryshme, ekziston një hapësirë për përfshirjen e OShC-ve.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>Me qasjen dhe legjislacionin e ri për ndërmarrjet sociale, ky program mund të bëhet më i rëndësishëm edhe për OShC-të në Kosovë. Aktualisht, synim primar i ka NVM-të.</p> <p>Zyra përfaqësuese për këtë program është në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Aktualisht, zyra është plotësisht funksionale. Pika Kombëtare e Kontaktit është znj. Arjeta Islami Muja, Udhëheqëse e Divizionit për Integrim Europian në Departamentin për Integrimin Europian dhe Koordinimin e Politikave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë (Arjeta.Islami@rks-gov.net / Tel: +381 (0) 38 200 36 624)</p>
----------	---	--	---	---	-----------	---	--

<p>4.</p>	<p>Erasmus +</p> <p>14,4 miliardë euro</p>	<p>Erasmus + është programi i ri për arsim, trajnim, rini dhe sport që synon të kontribuojë</p> <p>në zvogëlimin e shkallës së lartë të braktisjes së hershme të shkollës dhe rritjen e numrit të studentëve 30-34 vjeç që kanë përfunduar nivelin e tretë të arsimit.</p> <p>Qëllimet e Erasmus + janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mbështetë të rinjtë që të fitojnë aftësi më të shumta dhe më të mira duke studiuar dhe duke u trajnuar jashtë vendit. • Për të rritur cilësinë e mësimdhënies në BE dhe më gjerë. • Të mbështeten Shtetet Anëtare dhe vendet partnere në modernizimin e sistemeve të tyre të arsimit dhe trajnimit profesional. • Të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve në shoqëri. • Të mbështesë mësimdhënien dhe hulumtimin mbi integrimin evropian. • Të mbështesë sportin evropian me bazë në komunitet 	<p>Erasmus + është i hapur për shumë individë dhe organizata, edhe pse e drejta e pranimit ndryshon nga një aktivitet në tjetrin dhe nga një vend në tjetrin. Individët mund të marrin pjesë në shumë nga mundësitë e financuara nga Erasmus +, edhe pse shumica do ta bëjnë këtë përmes një organizate që merr pjesë në program. E drejta e pranimit të individëve dhe organizatave varet nga vendi në të cilin ato janë të vendosura.</p> <p>Vendet që kanë të drejtën e pranimit ndahen në dy grupe, vendet e Programit dhe vendet Partnere (vendet e BP). Edhe pse vendet e programit kanë të drejtë për të gjitha mekanizmat e Erasmus +, vendet Partnere mund të marrin pjesë vetëm në disa dhe varësisht prej kushteve specifike</p>	<p>Të gjitha vendet e rajonit (përveç Kosovës) marrin pjesë në Program.</p>	<p>PO</p>	<p>Interesim i konsiderueshëm pasi që ky program nxitë rolin e të rinjve në sfera të ndryshme të zhvillimit social dhe ekonomik, me theks të veçantë në arsim</p>	<p>Neni 22 i Rregullores parasheh që "bashkëpunimi në kuadër të Programit me organizatat e shoqërisë civile në fushën e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit, në nivel kombëtar dhe në Bashkësi është me rëndësi të madhe për të krijuar një ndjesi të gjerë të pronësisë në lidhje me strategjitë dhe politikave të mësuara gjatë gjithë jetës dhe për të marrë parasysh idetë dhe shqetësimet e palëve të interesuara në të gjitha nivelet". Më konkretisht, Mbështetja për reformën e politikave në kuadër të këtij programi përqendrohet tek të rinjtë dhe organizatat e ndryshme të të rinjve.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: Përveç institucioneve të arsimit (me theks të veçantë në arsimin e lartë), OJQ-të rinore, por edhe ato që janë aktive në arsim (qoftë në arsimin e lartë ose profesional) mund të përfitojnë nga ky program. Lidhja më e ngushtë dhe bashkëpunimi në rrjetet përkatëse evropiane është thelbësor.</p> <p>Tashmë ekzistojnë shembuj konkret të pjesëmarrjes së OShC-ve të Kosovës në këtë program (7 Arte nga Mitrovica në partneritet me Rrjetet Evropiane dhe Rajonale).</p> <p>Mekanizmi kryesor 2: Bashkëpunimi për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira; dhe Mekanizmi kryesor 3: Mbështetja për reformat e politikave janë me rëndësi të veçantë pasi që ato synojnë shkëmbimin e praktikave të mira në lidhje me rininë, si dhe mbështetjen për zhvillimin e politikave rinore. OShC-të e Kosovës kanë përvojë të madhe në programet e të rinjve dhe ato mund të sjellin një vlerë të shtuar në partneritetet me organizatat e BE-së.</p> <p>Sfidë specifike këtu është se meqë organizatat rinore në Kosovë janë kryesisht të vendosura në nivelin lokal dhe janë më të vogla në përmasa dhe veprimtari, bashkëfinancimi do të ishte një nga sfidat kryesore.</p> <p>Zyra përfaqësuese për këtë program:</p> <p>Adresa: Rruga Sejdi Kryeziu, nr. 49, Pejton, 10 000 Prishtinë office@erasmuspluskosovo.org +383 (0) 38 609 884</p> <p>Faqja në internet: http://erasmuspluskosovo.org</p>
-----------	--	--	---	---	-----------	---	---

5	<p>Europa Krijuese</p> <p>1,46 miliardë euro</p>	<p>Mbështetje për sektorët e kulturës, audiovizuel dhe sektorët e tërthortë (shpërndarja buxhetore indikative do të jetë 15% për pjesën ndërsektoriale, 30% për pjesën e Kulturës dhe 55% për pjesën e MEDIAS).</p> <p>Objektivat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mbështesë kapacitetin e sektorëve kulturorë dhe krijues Europeanë për të vepruar në nivel transnacional; • Promovimi i qarkullimit transnacional të veprave kulturore dhe krijuese dhe operatorëve dhe arritjes së audiencave të reja në Europë dhe më gjerë; • Përforcimi i kapacitetit financiar të sektorëve kulturorë dhe krijues, dhe në veçanti ndërmarrjeve dhe organizatave të vogla dhe të mesme; • Të mbështesë bashkëpunimin transnacional për politika me qëllim të nxitjes së zhvillimit të politikave, inovacionit, ndërtimit të publikut dhe modeleve të reja të biznesit. 	<p>Shtetet Anëtare;</p> <p>Vendet anëtare të EFTA dhe ZEE,</p> <p>Vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për anëtarësim,</p> <p>Konfederata Zvicerane; Vendet fqinje të zonës europiane</p>	Të gjitha vendet e rajonit (përveç Kosovës) marrin pjesë në Program.	PO	Interesim i konsiderueshëm pasi që ky program promovon kulturën dhe organizatat kulturore në aktivitetet e tyre krijuese	<p>Neni 3 i Rregullores thekson se programi synon të promovojë diversitetin kulturor dhe dialogun ndërkulturor, kulturën si një katalizator për krijimtarinë në kornizën e rritjes, punës dhe kulturës, si një element jetik në marrëdhëniet ndërkombëtare të BE-së. Për më tepër, Neni 21 thotë se në lidhje me zbatimin e Programit duhet të merren parasysh vlerat e brendshme të kulturës dhe natyra specifike e sektorëve kulturorë dhe krijues, duke përfshirë rëndësinë e organizatave jo-fitimprurëse dhe projekteve nga nën-programi i Kulturës.</p> <p><i>Deri në nëntor të vitit 2018, Kosova ende nuk ishte kualifikuar për pjesën e Mediave, për shkak të mospërputhjes të një akti të caktuar kombëtar ligjor me acquis të BE-së.</i></p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: Ky është një nga programet më tërheqëse për OShC-të, duke përfshirë edhe ato të Kosovës. Ka një numër të OJQ-ve të fuqishme, aktive në fushën e kulturës dhe medias, të cilat mund të kenë qasje në fondet e këtij programi. Bashkëpunimi rajonal dhe me BE-në, pjesëmarrja në rrjete të ndryshme duhet të forcohet më tej. Organizatat si Dokufest dhe Teatri ODA kanë marrë pjesë tashmë në këtë program. Përvoja e tyre duhet të ndahet me OJQ-të tjera në Kosovë.</p> <p>Në këtë program, OShC-të e Kosovës madje mund të kenë një rol udhëheqës në partneritet me organizatat kulturore rajonale dhe ato me seli në BE. Kultura e pasur e Kosovës mund të kontribuojë shumë në hartimin e aktiviteteve dhe aplikimit në thirrjen për propozime në kuadër të këtij programi. Megjithatë, partneritetet me organizatat me seli në BE dhe rajonale duhet të hulumtohen në mënyrë intensive. Bashkëfinancimi është sfidë edhe pse disa OShC të Kosovës mund ta menaxhojnë këtë përgjegjësi në varësi të fondeve të kërkuara.</p> <p>Zyra përfaqësuese është në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:</p> <p>NËN-PROGRAMI I KULTURËS</p> <p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Znj. Rina Gurgule Sheshi Nëna Terezë Nr. 35 10000 Prishtinë Republika e Kosovës +383 38 200 22 266 +383 45 651 005 E-mail: ced@rks-gov.net</p> <p><i>Deri në nëntor të vitit 2018, zyra përfaqësuese për nën-programin e medias nuk ishte krijuar.</i></p>
---	--	--	--	--	----	--	--

<p>6.</p>	<p>Hercule III</p> <p>105 milion euro</p> <p>(2014-2020)</p>	<p>Hercule III synon të ndihmojë vendet e BE-së të luftojnë mashtrimet, korrupsionin dhe aktivitetet e tjera të paligjshme. Ndhmon në financimin e projekteve praktike, siç është blerja nga autoritetet kombëtare të skanerëve me rreze x dhe pajisjeve të tjera teknike për të shuar kontrabandën dhe veprimtaritë e tjera kriminale kundër interesave financiare të BE-së.</p> <p>Aktivitetet e mbështetura: asistenca teknike, trajnimet e specializuara dhe furnizimi me pajisje</p>	<p>Administrata publike, OJQ-të (e nivelit kombëtar dhe rajonal), organizatat ndërkombëtare</p>	<p>- Mungesa e përvojave rajonale</p>	<p>JO</p>	<p>Interes i tërthortë për OShC-të e Kosovës për rolin monitorues ("watch dog") dhe të monitorimit. OShC-të e Kosovës mund të kontribuojnë në rritjen e njohurive për këtë program si dhe rritjen e transparencës së zbatimit të tij</p>	<p>OShC-të më shumë në rolin monitorues të rezultateve të aktiviteteve eventuale të programit të zbatuara në fushën e luftës kundër mashtrimit, korrupsionit dhe kontrabandës</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: Gjersa programi kryesisht synon institucionet me asistencë teknike si dhe furnizim me pajisje, OShC-të mund të kenë rolin monitorues ("watch dog") në luftën e përgjithshme kundër korrupsionit dhe kriminit të organizuar. OShC-të gjithashtu mund të kenë rol monitorues sa i përket zbatimit të këtij programi në mënyrë që Kosova të arrijë standardet dhe kërkesat e BE-së në këtë fushë.</p>
-----------	---	---	---	---------------------------------------	-----------	--	---

<p>7.</p>	<p>Drejtësia</p> <p>378 milion euro</p> <p>(2014-2020)</p>	<p>Do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të një hapësire europiane të drejtësisë bazuar në njohjen reciproke dhe besimin reciprok. Promovon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile, duke përfshirë çështjet civile dhe tregtare, paaftësinë paguese, çështjet familjare dhe trashëgimore, etj. - bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale - trajnimin në fushë e gjyqësorit, duke përfshirë trajnimin gjuhësor në terminologjinë ligjore, me synimin për të nxitur një kulturë të përbashkët ligjore dhe gjyqësore - qasjen efektive në drejtësi në Europë, duke përfshirë të drejtat e viktimave të krimit dhe të drejtat procedurale në procedurat penale - iniciativat në fushën e politikave për narkotikët (bashkëpunimi gjyqësor dhe aspekti i parandalimit të krimit) <p>Llojet e aktiviteteve të financuara</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aktivitetet e trajnimit (shkëmbimet e stafit, punëtoritë, zhvillimi i moduleve të trajnimit); Mësimin reciprok, aktivitetet e bashkëpunimit, shkëmbimi i praktikave të mira, rishikimet e kolegëve, zhvillimin e mjeteve të TIK-ut; Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes (studimet, grumbullimi i të dhënave, zhvillimi i metodologjive të përbashkëta, treguesit, anketat, përgatitja e udhëzuesve ...) 	<p>Qasja në Program do të jetë e hapur për të gjitha organet dhe subjektet publike dhe/ose private ligjërisht</p> <p>të themeluara në Shtetet Anëtare; vendet e EFTA-s të cilat janë palë në Marrëveshjen e ZEE-së,</p> <p>Vendet anëtare, vendet kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim</p>	<p>Serbia është pjesë e Programit të Drejtësisë. Bosnja dhe Hercegovina që nga viti 2016 dhe Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen në vitin 2016 në kuadër të reformës së drejtësisë.</p>	<p>JO</p>	<p>Ngjashëm me programin e mëparshëm, interes indirekt dhe në bashkërendim me programet e tjera (përveç këtyre 17) për të kontribuar drejt drejtësisë transparente dhe të qasshme për të gjithë</p>	<p>Ky program kryesisht synon institucionet gjyqësore, praktikuesit, institucionet trajnuese për drejtësi, të trajnuarit në profesionin e drejtësisë dhe të ngjashme. Në sinergji me programet e tjera, mund të përfshijë inpute të aktiviteteve të drejtuara nga OShC-të që marrin pjesë në programe të tjera.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: Shoqëria civile në Kosovë ka zhvilluar përvojë të vlefshme në monitorimin e punës dhe rolit të gjyqësorit në Kosovë. Duke vazhduar dhe forcuar këtë rol, OShC-të mund të kontribuojnë në mënyrë indirekte në këtë program.</p>
-----------	---	---	---	--	-----------	---	---

<p>8.</p>	<p>Programi për të drejta, barazi dhe shtetësi</p> <p>439 milion euro</p> <p>(2014-2020)</p>	<p>Do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të një hapësire ku promovohen dhe mbrohen barazia dhe të drejtat e personave, siç janë përcaktuar në Traktat, Kartën dhe Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.</p> <p>Nëntë objektivat specifike të tij janë:</p> <p>Promovimi i mos-diskriminimit; Luftimi i racizmit, ksenofobisë, homofobisë dhe formave tjera të mos tolerancës; Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; Promovimi i barazisë midis grave dhe burrave dhe integritit gjinor; Parandalimi i dhunës kundër fëmijëve, të rinjve, grave dhe grupeve të tjera në margjeralizuara (<i>Daphne</i>); Promovimi i të drejtave të fëmijëve; Sigurimi i nivelit më të lartë të mbrojtjes së të dhënave; Promovimi i të drejtave që rrjedhin nga posedimi i shtetësisë së BE-së; Respektimi i të drejtave të konsumatorit</p> <p>Aktivitetet e mbështetura: trajnimet/punëtoritë; ngritja e vetëdijes; shkëmbimi i praktikave të mira rishikimi/vlerësimi nga kolegët; zhvillimi i mjeteve të TIK, rrjetëzimi, etj.</p>	<p>Qasja në Program do të jetë e hapur për të gjitha organet dhe subjektet publike dhe/ose private ligjërisht</p> <p>të themeluara në Shtetet Anëtare; vendet e EFTA-s të cilat janë palë në Marrëveshjen e ZEE-së,</p> <p>Vendet anëtare, vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për anëtarësim</p>	<p>Nuk ka përvojë në rajon</p>	<p>PO</p>	<p>OShC-të e Kosovës nuk mund të marrin pjesë në këtë program pasi që nënshkrimi i MN-së është një nga kushtet kryesore.</p>	<p>Ky është një nga programet e BE-së që do të zbatohet kryesisht përmes bashkëpunimit me OShC-të. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe barazisë është një fushë ku OShC-të mund të sjellin vlerë më të mirë dhe të shtuar.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: OShC-të e Kosovës tanimë kanë shumë vite përvojë në këtë fushë të veçantë. Në Kosovë ekzistojnë rrjete të OShC-ve me fushëveprimtari të ngjajshme (Rrjeti i Grave të Kosovës, Koalicioni i OJQ-ve të Kosovës për Mbrojtjen e Fëmijëve, etj.) që mund të jenë pjesëmarrës të fuqishëm dhe kontribuues aktivë në këtë program. OShC-të e Kosovës janë gjithashtu anëtare të rrjeteve me seli në BE ose rrjeteve rajonale aktive në fushat relevante dhe kjo duhet të hulumtohet më tej në aspektin e pjesëmarrjes në këtë program pas nënshkrimit të MN-së.</p>
-----------	---	--	---	--------------------------------	-----------	--	---

<p>9.</p>	<p>Europa për qytetarët</p> <p>229 milion euro</p> <p>(2014-2020)</p>	<p>Programi synon të kontribuojë që qytetarët të kuptojnë BE-në, historinë dhe diversitetin e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxitja e qytetarisë europiane dhe përmirësimi i kushteve për pjesëmarrje qytetare dhe demokratike në nivel të BE-së 	<p>Shtetet Anëtare të BE-së, vendet e EFTA-s, vendet kandidatë dhe potenciale për anëtarësim. Të drejtë për financim kanë</p> <p>Institucionet hulumtuese europiane, autoritetet lokale, organizatat hulumtuese të politikave (<i>think-tanks</i>), grupet e qytetarëve dhe organizatat e tjera civile, institucionet arsimore, të cilat promovojnë qytetarinë aktive europiane.</p>	<p>Të gjitha vendet në rajon marrin pjesë në Program.</p>	<p>PO</p>	<p>Interes i konsiderueshëm për OShC-të e Kosovës pasi që MN-ja është ratifikuar së fundmi</p>	<p>Ky program është pothuajse plotësisht i arritshëm për OShC-të. Ai mbulon një spektër të gjerë të aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë takimet e qytetarëve, kontaktet dhe debatet mbi çështjet e qytetarisë, iniciativat për të rritur vetëdijen dhe për të promovuar reflektimin në përcaktimin e ngjarjeve të historisë europiane, iniciativat për të bërë qytetarët europianë, veçanërisht të rinjtë, të vetëdijshëm/informuar për historinë e BE-së dhe të funksionimit të institucioneve të BE-së, dhe debatet mbi çështjet e politikave europiane, me qëllim të forcimit të të gjitha aspekteve të jetës publike. Të gjitha këto aktivitete mund të zbatohen nga OShC-të.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: Duke pasur një perspektivë europiane, Kosova mund të përfitojë shumë nga ky program. Sidomos OShC-të në Kosovë. Bashkëpunimi i ngushtë me MIE është gjithashtu vendimtar. Bashkëpunimi me OShC-të në BE është një domosdoshmëri dhe shumë i rekomanduar. Pasi që MN për këtë program është nënshkruar dhe ratifikuar, OShC-të mund të marrin pjesë në thirrjet për propozime që nga shtatori i vitit 2018.</p> <p>Hapi i parë është regjistrimi në Portalin e Pjesëmarrësve të programit (http://ec.europa.eu/education/participants/portal/desktop/en/home.html).</p> <p>Bashkëfinancimi është një nga sfidat kryesore. Sfidë tjetër është edhe kapaciteti financiar dhe profesional i OShC-ve të Kosovës.</p> <p>Të kontrollohen afatet për projektet e Shoqërisë Civile në thirrjen për propozime 2018</p> <p>Zyra përfaqësuese për Kosovë është në kuadër të Ministrisë së Integritimit European, Departamenti i Asistencës për Zhvillim dhe Znj. Rita Saraci është emëruar si Pika Kombëtare e Kontaktit. rita.saraci@rks-gov.net +381 38 200 27028</p>
-----------	---	--	--	---	-----------	--	--

<p>10.</p>	<p>Mekanizmi i mbrojtjes civile</p> <p>368,3 milion (223,7 brenda BE-së dhe 144,6 jashtë BE-së)</p>	<p>Objektivat kryesore të Mekanizmit për Mbrojtjen Civile janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të arrijë një nivel të lartë të mbrojtjes nga fatkeqësitë duke parandaluar ose reduktuar efektet e tyre dhe duke nxitur një kulturë të parandalimit; • të përmirësojë gjendjen e gatishmërisë së BE-së për t'iu përgjigjur katastrofave ; • lehtësimi i ndërhyrjeve të shpejta dhe efikase të reagimit emergjent në rast të fatkeqësive të mëdha ose kërcënimit nga ato. 	<p>Shtetet Anëtare, vendet e ZEE-së dhe vendet kandidate të BE-së dhe kandidatët potencialë për anëtarësim. Në varësi të Thirrjes për Propozime, përfituesit e ndryshëm potencialë mund të marrin pjesë në program (për sa kohë që projektet nuk gjenerojnë fitime): Organet e administratës shtetërore, universitetet, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, kompanitë tregtare, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.</p>	<p>Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia marrin pjesë në program. Gjatë përmblytjeve të viteve të fundit Vendet kanë përfituar nga mekanizmi.</p>	<p>PO</p>	<p>Programi është me interes për OShC-të e Kosovës në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet përkatëse qeveritare përgjegjëse për këtë fushë të veçantë</p>	<p>Neni 18 i Rregullores parasheh që "Kur planifikohen operacionet e reagimeve, është e dobishme të mbajmë lidhje edhe me organizatat relevante joqeveritare dhe entitetet tjera relevante për të identifikuar ndonjë kapacitet shtesë të reagimit që ata mund të jenë në gjendje të vënë në dispozicion në rast të fatkeqësive përmes autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare". Në përgjithësi, sa i përket parandalimit të fatkeqësive si dhe asistencës, roli i OShC-ve ka qenë thelbësor dhe i nevojshëm. Një rast i tillë është dëshmuar edhe në Ballkanin Perëndimor, gjatë përmblytjeve në Serbi, Maqedoni dhe Shqipëri.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: OShC-të në Kosovë duhet të bëhen pjesë e mekanizmave përkatës kombëtarë në drejtim të parandalimit të katastrofave dhe ofrimit të asistencës. Bashkëpunimi rajonal këtu është më i rëndësishmi dhe me rol parësor. Bashkëpunimi me OShC-të relevante me seli në BE dhe rritëzimi i tyre është gjithashtu i mirëpritur, megjithatë i përket rëndësisë, mbetet si një element sekondar.</p> <p>Bashkëfinancimi zakonisht mundësohet/financohet nëpërmjet fondeve qeveritare që janë alokuar për çështjet emergjente dhe fatkeqësitë natyrore. Financimi nga donatorët është gjithashtu burim tjetër i zakonshëm i bashkëfinancimit.</p>
------------	---	--	---	---	-----------	---	--

<p>11.</p>	<p>Mundësitë e ndërveprimit për administratat publike, bizneset dhe qytetarët Europeanë (ISA2)</p> <p>131 milion euro</p>	<p>Programi ISA2 mbështet zhvillimin e mundësive dhe zgjidhjeve digjitale që u mundësojnë administratave publike, bizneseve dhe qytetarëve në Europë të përfitojnë nga shërbimet publike ndërkufitare dhe ndërsektoriale.</p>	<p>Vetëm administrata publike</p>	<p>Nuk ka përvojë rajonale meqenëse është programi i ri që vepron nga janari 2016</p>	<p>JO</p>	<p>JO (shih komentet mbi përfshirjen indirekte)</p>	<p>Qëllimi kryesor i programit është rritja e efikasitetit dhe transparencës së administratës publike. Kjo rrit rolin monitorues ("watch dog") të OSHC-ve.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: Administrata publike në Kosovë tashmë ka filluar zbatimin e parimeve dhe veprimeve kryesore të parapara për MS në këtë program: prokurimi elektronik, portali i e-qeverisjes, e-regjistri civil në nivel komunal, etj. OShC-të në Kosovë gjithashtu po monitorojnë këto shërbime. Prandaj, angazhimi i mëtejshëm në këtë fushë nga administrata publike dhe OShC-të duhet të parashihet.</p>
------------	---	---	-----------------------------------	---	-----------	---	--

12.	<p>Programi për punësim dhe inovacion social (EaSI)</p>	<p>Objektivat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fuqizimi i zbatimit të objektivave të BE-së dhe koordinimi i veprimeve në nivel të BE-së dhe në nivel kombëtar në fushat e punësimit, çështjeve sociale dhe të gjithë-përfshirjes. - Mbështetja e zhvillimit të sistemeve adekuata të mbrojtjes sociale dhe politikave të tregut të punës. - Modernizimi i legjislacionit të BE-së dhe sigurimi i zbatimit efektiv të tij. - Promovimi i mobilitetit gjeografik dhe rritja e mundësive të punësimit duke zhvilluar një treg të hapur pune. - Rritja e mundësive dhe qasjes në mikrofinanca për grupet e marginalizuara dhe mikro-ndërmarrjet, si dhe rritja e qasjes në financa për ndërmarrjet sociale. <p>Në synimin e arritjes së këtyre objektivave, EaSI do:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'i kushtoj vëmendje të veçantë grupeve të rrezikuara, siç janë të rinjtë, - të promovoj barazinë mes grave dhe burrave, - të luftoj diskriminimin, - të promovoj nivel të lartë të cilësisë dhe punësimit të qëndrueshëm, - të garantoj mbrojtje sociale adekuata dhe të denjë, - të luftoj papunësinë afatgjatë, - të luftoj kundër varfërisë dhe përjashtimit social 	<p>Shtetet Anëtare;</p> <p>Vendet anëtare të EFTA dhe ZEE,</p> <p>Vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për anëtarësim,</p> <p>Programi do të jetë i hapur për organet publike, dhe/ose private, akterët dhe institucionet, dhe në veçanti:</p> <p>(a) Autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale;</p> <p>(b) Shërbimet e punësimit;</p> <p>(c) Organet e specializuara të parashikuara sipas ligjit të BE-së;</p> <p>(d) Partnerët socialë;</p> <p>(e) Organizatat joqeveritare, dhe në veçanti ato të organizuara në nivel të BE-së;</p> <p>(f) Institucionet e arsimit të lartë dhe institutet hulumtuese;</p> <p>(g) Ekspertët në vlerësim dhe përcaktim të ndikimit;</p> <p>(h) Zyrat kombëtare të statistikave;</p> <p>(i) Mediat.</p>	<p>Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Shqipëria marrin pjesë në Program.</p>	<p>PO</p>	<p>Interes i ultë për OShC-të e Kosovës (shih komentet për interesin indirekt)</p>	<p>Neni 19 i rregullores thekson se <i>partnerët socialë dhe organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol kyç në promovimin e punësimit cilësor dhe luftimin e përjashtimit social dhe varfërisë, si dhe në luftën kundër papunësisë. Prandaj, partnerët socialë dhe organizatat e shoqërisë civile, aty ku është e mundshme, duhet të përfshihen në mësimin e ndërsjellë dhe në zhvillimin, zbatimin dhe shpërndarjen e politikave të reja. Komisioni duhet të informojë dhe shkëmbejë pikëpamjet me partnerët socialë të BE-së dhe me organizatat e shoqërisë civile mbi rezultatet që kanë të bëjnë me zbatimin e Programit.</i></p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>ky program synon një bashkëpunim të ngushtë me agjencitë relevante të OKB-së, Këshillin e Europës dhe OECD-në. Fakti që Kosova nuk është anëtare e këtyre organizatave ndërkombëtare paraqet barrierë të vërtetë për pjesëmarrjen e saj në program. Sidoqoftë, të njëjtat organizata kanë prani të fuqishme në Kosovë dhe kjo mund ta lehtësojë shumë këtë sfidë.</p> <p>Ky është gjithashtu një nga programet më tërheqëse për OShC-të në Kosovë. Ndërmarrjet sociale mund të promovohet edhe përmes këtyre programeve, që është një nga fushat e reja për Kosovën e që fuqishëm është e mbështetur nga OShC-të.</p>
-----	--	---	--	--	-----------	--	--

<p>13</p>	<p>Horizonti 2020</p> <p>80 miliardë euro</p>	<p>Programi Horizonti 2020 përbëhet nga pjesët e mëposhtme: "Shkencë e shkëlqyer"; "Lidershipi industrial"; "Sfidat shoqërore" (të gjitha të zbatuara nga Komisioni). Qëllimi është të sigurohet që Europa të prodhojë shkencë të klasit botëror, të heqë barrierat ndaj inovacionit dhe t'a bëjë më të lehtë për sektorin publik dhe privat që të punojnë së bashku në ofrimin e inovacioneve.</p>	<p>Shtetet anëtare të BE-së; vendet kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim; qendrat hulumtuese, administrata publike në nivel lokal dhe rajonal, korporatat, NVM-të, universitetet, organizatat jofitimprurëse, organizata ndërkombëtare.</p> <p>Vendet e treta të zgjedhura që përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:</p> <p>(i) kanë kapacitet të mirë në shkencë, teknologji dhe inovacion;</p> <p>(ii) kanë një histori të mirë të pjesëmarrjes në programet e hulumtimit dhe inovacionit të BE-së;</p> <p>(iii) Kanë lidhje të ngushta ekonomike dhe gjeografike me BE-në;</p>	<p>Të gjitha vendet e rajonit (përveç Kosovës) marrin pjesë në Program.</p> <p>Kosova merr pjesë në program si vend i asociuar</p>	<p>PO</p>	<p>Interes i konsiderueshëm për OShC-të e Kosovës të cilat janë më shumë të karakterit <i>think-tank</i></p>	<p>Neni 22 i Rregullores thekson që <i>me qëllim të thellimit të marrëdhënieve në mes të shkencës dhe shoqërisë dhe përforcimit të besimit të publikut në shkencë, Horizonti 2020 duhet të nxisë angazhimin e mirë-informuar të qytetarëve dhe shoqërisë civile në çështjet e hulumtimit dhe inovacionit duke promovuar edukimin shkencor, duke i bërë njohurit shkencore më të arritshme-qasshme, duke zhvilluar agjenda adekuate hulumtuese dhe të inovacionit që i adresojnë shqetësimet dhe pritjet e qytetarëve dhe shoqërisë civile dhe duke lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e Horizontit 2020. Angazhimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile duhet të shoqërohet me aktivitetet e informimit publik për të gjeneruar dhe siguruar mbështetjen e publikut për Horizontin 2020</i></p> <p>OShC-të kanë luajtur dhe do të vazhdojnë të luajnë një rol kyç në mbrojtjen e mjedisit, gjetjen e zgjidhjeve inovative dhe ngritjen e vetëdijes.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>Lidhja me rrjetet, organizatat, institutet hulumtuese ose "<i>think tanks</i>" europiane është një domosdoshmëri. Kapacitetet e përforcuara janë të nevojshme në fushën e inovacionit në mënyrë që të marrin pjesë aktivisht në program. KCSF tashmë ka marrë pjesë në program përmes aktiviteteve hulumtuese dhe përmes kontributeve individuale edhe aktiviteteve të zbatuara nga organizata.</p> <p>Laboratori Inovativ i Kosovës dhe aktivitetet e tij mund të përdoren si shembull i sferës së interesit të mundshëm në kuadër të këtij programi.</p> <p>Bashkëpunimi me universitetet (publike ose private), "<i>think tanks</i>" tjera është i nevojshëm për këtë program.</p> <p>OShC-të e Kosovës mund të marrin pjesë si partnerë ose individë të asociuar.</p>
-----------	---	---	---	--	-----------	--	--

<p>14.</p>	<p>Programi 'Shëndeti për Rritje'</p> <p>449,4 milion euro</p>	<p>Promovimi i shëndetit, parandalimi i sëmundjeve dhe nxitja e mjediseve mbështetëse për jetesë të shëndetshme duke marrë parasysh parimin "shëndeti në të gjitha politikat",</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e qytetarëve të BE-së nga kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin, • Kontributi në sistemet shëndetësore inovative, efikase dhe të qëndrueshme, • Lehtësimi i qasjes në kujdesin shëndetësor më të mirë dhe më të sigurt për qytetarët e BE-së. 	<p>Shtetet Anëtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendet e EFTA/ZEE (me përjashtim të Zvicrës) • Vendet candidate dhe vendet potenciale candidate për anëtarësim në bazë kostoje, • Vendet tjera në bazë të marrëveshjes dypalëshe ose shumëpalëshe • Subjektet publike dhe private që merren me Shëndetësi 	<p>Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia marrin pjesë në Programin e Shëndetit.</p>	<p>PO</p>	<p>Interes i madh për OShC-të e Kosovës i kushtëzuar me nënshkrimin e MN-së</p>	<p>Ndërgjegjësimi, parandalimi dhe mbrojtja janë fushat ku OShC-të mund të kenë një rol aktiv në këtë program.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>Ka një numër të OShC-ve në Kosovë që merren me çështjet e shëndetit, kryesisht duke u fokusuar në parandalim dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Për më tepër, roli avokues i OShC-ve sa i përket zhvillimit të politikave përkatëse dhe promovimit të zbatimit të tyre është gjithashtu relevant dhe mund të konsiderohet në kuadër të këtij programi. Partneritetet formale me OShC-të ose rrjetet me seli në BE janë një domosdoshmëri.</p> <p>OShC-të e Kosovës aktualisht mund të aplikojnë si palë bashkëpunuese ose subjekte të lidhura</p>
------------	--	---	---	--	-----------	---	--

<p>15.</p>	<p>Programi i Konsumatorit</p> <p>197 milion euro</p>	<p>Programi do të kontribuojë për të mbrojtur shëndetin, sigurinë dhe interesat ekonomike të konsumatorëve, si dhe për të promovuar të drejtën e tyre për informacion, edukim dhe për t'u organizuar në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shtetet anëtare • Vendet e ZEE • Vendet Kandidate për anëtarësim • Vendet e Ballkanit Perëndimor • Vendet e treta të mbuluara nga Politika Europiane e Fqinjësisë <p>Organizatave të mëposhtme kanë të drejtë për financim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organet publike • Organizatat jofitimprurëse • Organizatat joqeveritare, jofitimprurëse dhe të pavarura të konsumatorëve europianë • Zyrtarët për mbrojtjen e konsumatorëve <p>Kontributi i BE-së mund të jetë deri në 50% ose 70%, varësisht nga aktiviteti.</p>	<p>Nuk ka përvojë në nivel rajonal</p>	<p>PO</p>	<p>Interes solid për OShC-të e Kosovës - kushtëzuar me nënshkrimin e MN-së</p>	<p>Neni 19 i Rregullores së BE-së për Programin e Konsumatorit thekson se: <i>"Në kontekstin e zbatimit të Programit dhe duke pasur parasysh globalizimin e zinxhirit të prodhimit dhe ndërvarësinë në rritje të tregjeve, bashkëpunimi me vendet e treta që nuk marrin pjesë në Program duhet të inkurajohet, duke marrë parasysh çdo marrëveshje relevante midis këtyre vendeve dhe BE-së "</i>.</p> <p>Meqenëse ky program synon në mënyrë specifike organizatat që promovojnë mbrojtjen e konsumatorit, është shumë i rëndësishëm për OShC-të.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>partneritetet me rrjetet e mbrojtjes së konsumatorit me seli në BE (si Rrjeti i Bashkëpunimit për Mbrojtjen e Konsumatorëve) janë hapi i parë drejt qasjes së mundshme në fondet e këtij programi. Kosova si vend dhe OShC-të e Kosovës në veçanti kanë përvojë të kufizuar në këtë fushë. Prandaj, partneriteti me rrjetet apo organizatat europiane është një hap i parë i domosdoshëm.</p>
------------	---	--	--	--	-----------	--	--

<p>16.</p>	<p>LIFE</p> <p>3,1 miliardë euro</p>	<p>Programi LIFE është instrument financimi i BE-së për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.</p> <p><i>Komponenta</i> e programit të ri 'mjedisi' mbulon tri sfera me prioritet: mjedisi dhe efikasiteti i resurseve; natyra dhe biodiversiteti; dhe qeverisja dhe informacioni për mjedisin. <i>Komponenti 'aksioni për ndryshimet klimatike'</i> përshtin zvogëlimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike; përshtatjen në ndryshimet klimatike; qeverisja me politikën për ndryshimet klimatike;</p> <p>Programi gjithashtu përbëhet nga një kategori e re projektësh, projekte të integruara e bashkërisht të financuara, të cilat do të veprojnë në një hapësirë më të madhe territoriale. Këto projekte do të synojnë të zbatojnë politikën për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.</p>	<p>Programi LIFE mund të financojë organe publike dhe private.</p> <p>Programi LIFE do të jetë i hapur për pjesëmarrjen e vendeve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendet e Organizatës Europiane të Tregtisë së Lirë (EFTA) të cilat janë palë në Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Europiane (ZEE); • Vendet kandidate, kandidate potenciale për anëtarësim dhe vendet anëtare në BE; • Vendet për të cilat zbatohet Politika Europiane e Fqinjësisë; • Vendet që janë bërë anëtare të Agjencisë Europiane të Mjedisit 	<p>Asnjë eksperiencë rajonale</p>	<p>PO</p>	<p>Interes i ulët aktual për OShC-të e Kosovës</p>	<p>Një nga objektivat kryesore të këtij programi është mbështetja e qeverisjes më të mirë të mjedisit dhe për ndryshimet klimatike në të gjitha nivelet, duke përfshirë përfshirjen më të mirë të shoqërisë civile, OJQ-ve dhe akterëve lokalë dhe për të mbështetur zbatimin e Programit të 7-të Veprimeve për Mjedisin.</p> <p>Neni 29 i Rregullores thekson se <i>suksesi i projekteve të integruara varet nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe akterëve jo-shtetërorë të përfshirë në objektivat e Programit LIFE.</i></p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat: Si në fushën e inovacionit, kapacitetet e OShC-ve të Kosovës duhet të forcohen më tej në mënyrë që të marrin pjesë aktivisht në këtë program.</p>
------------	--	---	---	-----------------------------------	-----------	--	--

17.	Koperniku 3,8 milion euro	<p>□Programi</p> <p>Synon të sigurojë një qasje të vazhdueshme, të pavarur dhe të besueshme në informacionin e vëzhgimit të tokës/botës.</p> <p>Është e strukturuar në gjashtë shërbime të ndryshme: monitorimi i detit, atmosferës, tokës dhe ndryshimeve klimatike</p> <p>si dhe mbështetje për shërbimet emergjente dhe të sigurisë. Koperniku përdor të dhëna nga satelitët dhe sensorët në vend siç janë sensorët pluskues apo të ajrit për të siguruar informacion dhe parashikim në kohën e duhur dhe të besueshëm për të mbështetur (për shembull) bujqësinë dhe peshkimin, përdorimin e hapësirës dhe planifikimin urban, luftën kundër zjarreve në pyje, transportin detar ose monitorimin e ndotjes së ajrit</p>	<p>(a) vendet e EFTA-s të cilat janë palë kontraktuese të Marrëveshjes së ZEE-së;</p> <p>(b) vendet kandidate, si dhe vendet potenciale kandidate për anëtarësim</p> <p>(c) Zvicra, vendet tjera të treta dhe organizatat ndërkombëtare, në përputhje me</p> <p>Marrëveshjet e lidhura nga BE-ja me këto vende ose organizata ndërkombëtare dhe kriteret për përfshirjen e tyre.</p> <p>Përdoruesit kryesorë janë politikë-bërësit dhe autoritetet publike që kanë nevojë për informacion për të zhvilluar</p> <p>legjisllacionin dhe politikat mjedisore ose për të marrë vendime kritike në rast emergjence.</p>	Asnjë eksperiencë rajonale	JO	JO	<p>Institucionet dhe organizatat në fushën e shkencës dhe inovacionit mund të përfitojnë nga ky program. Kapaciteti i domosdoshëm është kusht kryesor. Institucionet dhe organet shkencore mund të jenë pjesëmarrëse aktive të këtij programi.</p> <p>Kriteret/përparësitë/sfidat:</p> <p>Si në fushën e inovacionit, kapacitetet e OShC-ve të Kosovës duhet të forcohen më tej në mënyrë që të marrin pjesë aktivisht në këtë program.</p>
-----	--	---	---	----------------------------	----	----	--

2.2 Informacion i përgjithshëm mbi procedurën e aplikimit dhe kriteret

Për programet e BE-së, të cilat identifikohen si programe me interes të veçantë për OShC-të, siç janë Europa për Qytetarët, Europa Krijuese ose ERASMUS + dhe programet tjera të ngjashme (për më shumë detaje shihni tabelën e hartëzimit) është paraparë një proces aplikimi në fazë dhe procedura të ndryshme. Nëse programi përfshin thirrje të hapura për propozime për OShC-të, ekzistojnë disa kriteret që janë të përbashkëta si në të gjitha thirrjet e BE-së për propozime për OShC-të. Kriteret e tilla mund të jenë si më poshtë:

- Aplikantët duhet të jenë organe publike ose organizata jofitimprurëse – persona juridik
- Programet janë të hapura për 28 Shtetet Anëtare të BE-së - dhe me kushtin që të kenë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Komisionin - për vendet në anëtarësim, vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale
- Zakonisht, projekti duhet të përfshijë organizata nga të paktën një shtet anëtar i BE-së
- Preferenca u jepet zakonisht projekteve transnacionale.

Gjatë vlerësimit të aplikimit, sa i përket cilësive dhe kriterëve për praninë ose përjashtim në aplikim, merren parasysh me sa vijon.

Aplikantët duhet të kenë:

- Burime të mjaftueshme të financimit për të mbështetur aktivitetin e tyre për kohëzgjatjen e aktivitetit të propozuar
- Kompetencat profesionale dhe motivimi për të realizuar projektin e propozuar.

Propozimet pastaj vlerësohen në bazë të:

- Përputhshmërisë me objektivat e programit dhe komponentës së programit
- Cilësisë së planit të veprimit të projektit
- Përhapjes
- Ndikimit dhe përfshirjes së qytetarëve (nëse ky është një prej objektivave kryesore të programit)

Pesha e kriterëve të sipërpërmendura është e vlefshme në mënyrë të barabartë për aplikantin kryesor dhe organizatat partnere. Kjo do të thotë se nëse aplikanti kryesor është një organizatë e BE-së që është duke bashkëpunuar me OShC-të e Kosovës, nga OShC-të e Kosovës do të kërkohet që të përmbushin kriteret e lartpërmendura. Në të vërtetë, programet dhe thirrjet e tyre për propozime zakonisht mund të lejojnë që organizata udhëheqëse të ketë një bashkëpunëtor ose që përmes nën-grantit t'ia jap aktivitetet e projektit organizatave tjera. Në këtë rast, pesha e kriterëve të përshtatshme për aplikim ndryshon në mesin e subjekteve të ndryshme që marrin pjesë në projekt.

Në terma më praktikë, çdo aplikant duhet të ketë një llogari identifikuese (Shërbimi i Autentifikimit të Komisionit Europian) në BE. Çdo organizatë e përfshirë në projekt (aplikanti dhe partnerët) duhet të regjistrohen në Portalin e pjesëmarrjes dhe të marrin Kodin e identifikimit të pjesëmarrësve (PIC). Të gjitha dokumentet relevante, si forma e entitetit ligjor, certifikata e regjistrimit dhe të ngjashme janë të ngarkuara në këtë portal.


Ka udhëzime të hollësishme në dispozicion për aplikantët për secilin nga programet e BE-së. Programet kanë faqet e tyre të internetit, si <https://eacea.ec.europa.eu/europe-for-citizens> ose <https://eacea.ec.europa.eu/creative-europe>, të cilat duhet të konsultohen rregullisht për informacion të përditësuar mbi mundësitë e financimit, projektet në zbatim për t'u përdorur si praktika të mira, si dhe për të marrë informacion të dobishëm mbi partneritetet e mundshme me organizatat e tjera simotra. Përveç kriterëve të përbashkëta siç është përmendur më lart, secili program dhe çdo thirrje për propozime ka objektiva specifike dhe kërkesa specifike të lidhura me aktivitetet në përputhje me objektivat e programit. Aplikacionet do të vlerësohen kundrejt një sërë kriteresh të cilat janë në dispozicion si pjesë e udhëzimeve për çdo thirrje për propozime.

Për pjesëmarrje në programet e BE-së dhe thirrjet e tyre për propozime, zyrat përfaqësuese janë në kontakt të ngushtë me Komisionin Europian dhe delegacionet e tij në vende të veçanta (në Kosovë është Zyra e BE-së në Kosovë), prandaj kanë informacione të përditësuara për thirrjet më të reja dhe mundësitë e financimit. Zyrat e tilla janë themeluar në Kosovë dhe janë të vendosura në Ministrinë e Integritit Europian, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në Universitet/Zyra e Erasmus + në Kosovë. Informacioni i detajuar kontaktues për këto zyra është dhënë në tabelën e mëposhtme si pjesë e hartëzimit.

Përvoja në rajonin e Ballkanit Perëndimor në lidhje me programet e BE-së tregon se zyrat përkatëse dhe institucionet qeveritare pjesë e të cilave janë, ishin në gjendje të ndajnë fonde që kanë shërbyer si bashkëfinancim për OShC-të dhe organizatat kulturore me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes së tyre në programet e BE-së. Përveç kësaj, janë organizuar programe për ngritjen e kapaciteteve si dhe sesione informative për të ndarë informacionin dhe për të rritur njohuritë mbi programet e BE-së si dhe fondet dhe mundësitë e tyre. Kjo është iniciuar edhe në Kosovë, si nga institucionet përkatëse qeveritare (Ministria e Integritit Europian, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, etj.) ashtu edhe nga OShC-të (KCSF, Dokufest, etj.). Sesionet e informimit organizohen nga zyrat përfaqësuese ose nga ministrinë përgjegjëse. Tryeza të rrumbullakëta ose punëtori organizohen nga OShC-të, ku pjesëmarrësit nga Ballkani Perëndimor janë ftuar të ndajnë përvojën e tyre konkrete me pjesëmarrjen në programet e BE-së. Këto aktivitete duhet të vazhdojnë dhe intensivohen dhe duhet të shihen si hapa fillestarë të pjesëmarrjes aktive në këto programe.

2.3 Kosova në Programet e BE-së

Siç u përmend më parë, Kosova ka nënshkruar MN-të për katër nga programet në vazhdim. Më poshtë është përshkrimi i shkurtër i këtyre programeve:

 Programi për Aftësinë Konkurruese të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme https://ec.europa.eu/easme/en/cosme	
Buxheti 2014-2020 i BE-së: 2.3 miliardë euro	Koordinatori Kombëtar/Përfituesi: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / KIESA (Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve). Marrëveshja me KE është nënshkruar më 19 dhjetor 2017
Objektivat:	Programi është themeluar me Rregulloren (EU) Nr. 1288/2013 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 me qëllim të promovimit të aftësisë konkurruese dhe qëndrueshmërisë së NVM-ve, sektorit të turizmit, nxitjes së kulturës ndërmarrëse dhe promovimit të krijimit dhe rritjes së NVM-ve. Fushat kryesore të ndërhyrjes janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Lehtësimi i qasjes në financa; ▪ Mbështetje ndërkombëtarizimit dhe qasjes në tregje; ▪ Krijimi i një mjedisi të favorshëm për konkurrencën; ▪ Inkurajimi i kulturës ndërmarrëse
Lloji i mekanizmave:	<p>i. Qasje më të mirë në financa për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) Qëllimi është të sigurojë qasje të zgjeruar për financimin e NVM-ve në faza të ndryshme të ciklit jetësor të tyre: krijimi, zgjerimi ose transferimi i biznesit. COSME mobilizon huat dhe investimet e kapitalit për NVM-të, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Instrumentit të Garantimit të Huas, duke ofruar garanci për institucionet financiare (p.sh. shoqëritë e garancisë, bankat, kompanitë e lizingut) në mënyrë që ata të mund të ofrojnë më shumë financim të kredisë dhe lizingut për NVM-të. - Instrumenti i Kapitalit për Rritje siguron kapital për fondet që investohen në NVM kryesisht në fazën e zgjerimit dhe fazës së rritjes. <p>ii. Qasja në tregje</p> <ul style="list-style-type: none"> - COSME siguron mbështetje për ndërmarrjet europiane në mënyrë që ato të përfitojnë nga tregu unik i BE-së dhe të shfrytëzojnë sa më shumë mundësitë e ofruara nga tregjet jashtë BE-së. - COSME financon Rrjetin e Ndërmarrjeve Europiane (EEN) që përbëhet nga mbi 600 zyra në më shumë se 50 vende, duke ndihmuar NVM-të të gjejnë partnerë biznesi dhe teknologjie për qasje në tregje. <p>iii. Inkurajimi i ndërmarrësisë</p> <ul style="list-style-type: none"> - COSME mbështet zbatimin e Planit të Veprimit për Ndërmarrësi 2020 përmes një game të gjerë aktivitetesh. Këto përfshijnë shkëmbimin e mobilitetit, hulumtimin, përhapjen e praktikave më të mira dhe pilot projektet në fusha të tilla si edukimi për ndërmarrësi, mentorimi ose zhvillimi i shërbimeve udhëzuese dhe mbështetëse për ndërmarrësit e rinj dhe potencialë, duke përfshirë ndërmarrësit e rinj, gra dhe të ata me përvojë më të gjatë. - Erasmus për Ndërmarrësit e Rinj është një skemë ndërkufitare e shkëmbimit e cila ndihmon ndërmarrësit e rinj të fitojnë aftësi relevante për të drejtuar dhe zhvilluar një biznes duke punuar me një ndërmarrës me përvojë në një vend tjetër për një periudhë një deri në gjashtë muaj. - COSME përqendrohet veçanërisht në ndërmarrësinë digjitale për të ndihmuar bizneset europiane të nxisin transformimin e tyre digjital dhe të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e reja të paprecedentë të krijuara në epokën digjitale, të cilat janë vendimtare për aftësinë konkurruese dhe rritjen e tyre. <p>iv. Krijimi i kushteve më të mira kornizë për konkurrencë - kushte të favorshme për krijimin dhe rritjen e biznesit</p> <ul style="list-style-type: none"> - COSME mbështet aktivitetet për të përmirësuar kushtet kornizë në të cilat ndërmarrjet veprojnë, në veçanti NVM-të, duke reduktuar ngarkesat e panevojshme administrative dhe rregullatore. - COSME mbështet shfaqjen e industrive konkurruese me potencial të tregut, duke ndihmuar NVM-të për të marrë modele të reja biznesi dhe për t'u integruar në zinxhirët vlerave të reja. - COSME promovon zhvillimin e klasterëve të klasit botëror në BE, duke nxitur përsosmërinë e klasterit dhe ndërkombëtarizimin me theks në bashkëpunimin ndërsektorial, veçanërisht në mbështetje të industrive në zhvillim. Programi synon gjithashtu përsheptimin e digjitalizimit të komunitetit të biznesit dhe promovimin e shkathtësive elektronike (digjitale) dhe udhëheqjes elektronike (digjitale).
Pjesëmarrja e OShC-ve të Kosovës:	Ky program nuk synon drejtpërsëdrejti OShC-të. NVM-të dhe ndërmarrësit e rinj janë në qendër të këtij programi.



ERASMUS Plus - Programi për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport

https://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus_en

Buxheti 2014-2020 i BE-së: 14,7 miliardë euro

Koordinatori Kombëtar/Përfituesi: **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**
Marrëveshja me KE është nënshkruar më 5 qershor 2018

Objektivat:

Erasmus + është program i BE-së në **fushën e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit me qëllim që të kontribuojë në strategjinë e Europës 2020 për rritjen, punësimin, barazinë sociale dhe gjithëpërfshirjen**. Erasmus + gjithashtu synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm të partnerëve të saj në fushën e arsimit të lartë dhe të kontribuojë në arritjen e objektivave të Strategjisë së BE-së për Rininë

Lloji i mekanizmave:

i. Mekanizmi kryesor 1: Mobiliteti i individëve për mësim

- Mobiliteti i individëve në sferën e arsimit, trajnimit dhe të rinjve; Master i Përbashkët Erasmus Mundus⁴

ii. Mekanizmi kryesor 2: Bashkëpunimi për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira

- Partneritetet strategjike në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë; Aleancat e Njohurive; Aleancat e Aftësive të Sektorit; Ngritja e kapaciteteve në fushën e arsimit të lartë; ngritjen e kapaciteteve në sferën e të rinjve⁵.

iii. Mekanizmi kryesor 3: Mbështetje për reformën e politikave

- Dialogu i strukturuar: takime në mes të rinjve dhe vendimmarrësve në fushën e të rinjve

Iniciativa Jean Monnet

- Synimi i aktiviteteve Jean Monnet është për të promovuar mësimdhënien dhe punën hulumtuese për integrimin europian në tërë botën në mesin e akademikëve të specializuar, studentëve dhe qytetarëve, sidomos nëpërmjet krijimit të katedrave Jean Monnet dhe aktiviteteve të tjera akademike, si dhe duke ofruar ndihmë për aktivitetet e ngritjes së njohurive në institucionet e arsimit të lartë; për të mbështetur aktivitetet e institucioneve akademike ose shoqatave aktive në fushën e studimeve të integrimin europian dhe për të mbështetur etiketën Jean Monnet për përsosmëri. Duke pasur parasysh përpjekjet e saj specifike për të promovuar përsosmërinë në arsim dhe hulumtimin për integrimin në BE, iniciativa Jean Monnet do të vazhdojë si një aktivitet i veçantë brenda Programit dhe do të ndajë me të tjerët mekanizmat e saj të shpërndarjes.

Mekanizmi për Sportin

- projektet bashkëpunuese transnacionale; ngjarje sportive europiane jofitimprurëse të një rëndësie të madhe; forcimi i bazës së të dhënave për hartimin e politikave në fushën e sportit; ngritja e kapaciteteve në sport; dialogu me akterët përkatës europianë.

Pjesëmarrja e OSHC-ve të Kosovës:

Mekanizmi kryesor 2 dhe 3 synojnë kryesisht OSHC-të aktivitetet e të cilave përfshijnë rininë, shkëmbimin e praktikave të mira dhe promovimin e rolit të të rinjve në vendimmarrje dhe politikë-bërje. Për më tepër, mekanizmi për sportin është gjithashtu një prioritet i këtij programi që është tërheqës për OSHC-të.

OSHC-të e Kosovës kanë marrë pjesë tashmë në këtë program përmes partneriteteve me organizatat dhe rrjetet rajonale dhe të BE-së. Duke nënshkruar MN për këtë program, Kosova i ka mundur OSHC-ve të saja të kenë rol më të dukshëm në procesin e aplikimit - ato mund të jenë aplikues kryesor ose bashkë-aplikues, varësisht nga aktiviteti i propozuar dhe thirrja specifike. OSHC-të e Kosovës duhet të përgatiten për thirrjet që do të shpallen në vitin 2019.

Kontakti me zyrën e Erasmus + duhet të bëhet menjëherë në mënyrë që të marren informata më të detajuara për thirrjen e ardhshme për propozime dhe kërkesat e ndryshme. Faqja e internetit ERASMUS + në Kosovë <http://erasmuspluskosovo.org> përfshin informata relevante për të gjitha zhvillimet e ERASMUS +, thirrjet e tyre të hapura dhe oraret përkatëse. Shumica e thirrjeve janë të hapura deri në fund të tetorit 2018 (ose më herët). Linqet e faqeve përkatëse për regjistrim, aplikim dhe marrjen e informatave të detajuara mbi thirrjet për propozime janë në dispozicion në këtë faqe interneti.

⁴ Kosova ka marrë pjesë aktive në këtë lloj mekanizmi. Programi është i njohur për studentët, si dhe për organizatat që lehtësojnë shkëmbimet e studentëve

⁵ Ekziston njëfarë përvojë ndërmjet OSHC-ve të Kosovës në këtë mekanizëm të veçantë. OSHC-ja 7 Arte nga Mitrovica ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në një mekanizëm të tillë në partneritet me BE-në dhe organizatat dhe rrjetet rajonale



Europa Krijuese

https://eacea.ec.europa.eu/creative-europe_en

Buxheti 2014-2020 i BE-së: 1,46 miliardë euro

Koordinatori Kombëtar/Përfituesi: **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**
Marrëveshja me KE është nënshkruar më 5 qershor 2018

Objektivat: Programi Europa krijuese jep mbështetje për të **mbrojtur dhe promovuar diversitetin kulturor dhe gjuhësor evropian** dhe për të mbështetur iniciativat e sektorit kulturor dhe audiovizuel. Synimet e programit janë:

- Të ndihmojë sektorët kulturorë dhe krijues të shfrytëzojnë mundësitë e epokës digjitale dhe globalizimit; Të mundësojë sektorët të arrijnë potencialin e tyre ekonomik, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme, vende të punës dhe kohezionin social; t'i japë sektorit të kulturës dhe mediave të Europës qasje në mundësi, tregje dhe audiencë të reja ndërkombëtare.

Llojet e mekanizmave:

- Programi i **Kulturës** ka 4 thirrje për propozime çdo vit; (i) Komponenti i përkthimit letrar; (ii) Projektet e bashkëpunimit; (iii) Rrjetet Europiane; (iv) Platformat Europiane⁶

Pjesëmarrja e OShC-ve të Kosovës

Duhet të theksohet se Kosova nuk kualifikohet për nën-programin e Medias brenda Europës Krijuese. Kjo për shkak se ligji përkatës lidhur me mediat nuk është harmonizuar me *acquis* relevante të BE-së.

Ky program është shumë tërheqës për OShC-të, veçanërisht për organizatat kulturore. Më konkretisht, mekanizmat si projektet e bashkëpunimit, rrjetet europiane dhe platformat europiane synojnë në mënyrë të veçantë OShC-të. MN është nënshkruar dhe ratifikuar në shtator të vitit 2018. Kjo do të thotë se OShC-të e Kosovës mund të marrin pjesë në thirrjet e vitit 2019. Partneriteti me organizatat me seli në BE është një nga kriteret kryesore. OShC-të e Kosovës kanë një vlerë të shtuar pasi ato përfaqësojnë shoqëri të larmishme kulturore dhe kjo duhet të përdoret maksimalisht kur të aplikohet për këtë program.

Faqja e internetit të Europës Krijuese <https://eacea.ec.europa.eu/creative-europe> përfshin të gjithë informacionin e duhur për thirrjet për propozime të hapura dhe të ardhshme. Varësisht nga mekanizmi dhe thirrja specifike, OShC-të e Kosovës duhet të regjistrohen në Portalin e Pjesëmarrjes dhe të aplikojnë sipas Udhëzimeve për thirrjen specifike. Kriteret e përshtatshmërisë, siç është shpjeguar më parë kanë të bëjnë me ligjshmërinë e organizatave, që duhet të jenë nga një Shtet Anëtar i BE dhe/ose vend në anëtarësim ose para-anëtarësim – dhe që është relevante për Kosovën - nëse ai vend ka nënshkruar marrëveshjen me Komisionin Europian. Për më tepër, kriteret do të ndërliken me objektivin specifik të thirrjes. Aktualisht, njoftimet për thirrjet për vitin 2019 po publikohen në faqen e internetit të Europës Krijuese. Zyra përfaqësuese për Kosovë në kuadër të MKRS duhet të kontaktohet për hollësi të mëtejshme.

⁶ Dokufest, Teatri ODA, 7 Arte kanë marrë pjesë më parë në këtë program përmes partneriteteve me organizatat dhe rrjetet e BE-së



Programi Europa për Qytetarët

https://eacea.ec.europa.eu/europe-for-citizens_en

Buxheti 2014-2020 i BE-së: 185 468 000 milion euro	Koordinator Kombëtar/Përfituesi: Ministria e Integritimit Europian Marrëveshja me KE është nënshkruar më 26 qershor 2018
Objektivat:	Europa për Qytetarët synon të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve dhe organizatave nga vende të ndryshme dhe të lehtësojë zhvillimin e një ndjenje të përkatësisë ndaj idealeve të përbashkëta Europiane dhe të promovojë procesin e integritimit europian.
Lloji i mekanizmave: <i>i. Kujtesa Europiane</i> - Projektet që pasqyrojnë diversitetin kulturor europian dhe vlerat e përbashkëta me një dimension të qartë europian; Projektet që adresojnë shkaqet e regjimeve totalitare në historinë moderne të Europës (posaçërisht por jo vetëm nazizmin, fashizmin, stalinizmin dhe regjimet totalitare komuniste) dhe për të përkujtuar viktimat e krimeve të tyre; Projektet në lidhje me aktivitetet që inkurajojnë tolerancën, mirëkuptimin reciprok, dialogun ndërkulturor dhe pajtimin, në veçanti duke synuar të arrihet brezi i ri. <i>ii. Angazhimi demokratik dhe pjesëmarrja qytetare</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Binjakëzimi i qyteteve Projektet që bashkojnë qytetarët nga qytetet e binjakëzuara për të debatuar çështje nga agjenda politike europiane. Ata do të zhvillojnë mundësi për angazhim shoqëror dhe vullnetarizëm në nivel të BE-së. <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rrjeti i Qyteteve Qytetet inkurajohen të bashkëpunojnë me qytete të tjera në baza afatgjata për të ndarë burimet ose interesat, për të fituar ndikim ose për t'u përballur me sfida të përbashkëta <ul style="list-style-type: none"> ▪ Projektet e Shoqërisë Civile Promovimi i angazhimit shoqëror dhe solidaritetit: promovimi i fushatave të debatit mbi temat e interesit të përbashkët, duke e bërë ndëlidhjen me agjendën politike europiane; Vullnetarizmi: nxitja e solidaritetit midis qytetarëve të BE-së dhe më gjerë; avokimi për politikën e BE-së dhe lidhja me agjendën e politikave të BE-së dhe procesin e politikë-bërjes; Fushatat e debatit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve të BE-së; Mbledhja e mendimeve dhe pikëpamjeve mbi tema të ndryshme të politikave të BE-së; Promovimi i vullnetarizmit, promovimi i solidaritetit midis qytetarëve të BE-së dhe përtej iniciativave që zhvillojnë mundësi për mirëkuptim reciprok, solidariteti i mësimit ndërkulturor, angazhim shoqëror dhe vullnetarizëm në nivel të BE-së.	
Pjesëmarrja e OShC-ve të Kosovës	Marrëveshja për këtë program është nënshkruar dhe ratifikuar. Faqja e internetit e programit https://eacea.ec.europa.eu/europe-for-citizens_en ofron informacion të përditësuar për thirrjet e hapura dhe të ardhshme për propozime. Aktualisht, thirrjet për vitin 2019 ende nuk janë shpallur. Rezultatet e përzgjedhjes për thirrjet e vitit 2018 janë në dispozicion. Varësisht nga mekanizmi dhe thirrja specifike, OShC-të e Kosovës duhet të regjistrohen në Portalin e Pjesëmarrjes dhe të aplikojnë sipas Udhëzimeve për thirrjen specifike. Për aplikim në «Projektet e Shoqërisë Civile» duhet të ketë partneritetet me organizatat me seli në BE. Zyra përfaqësuese në kuadër të MIE duhet të kontaktohet rregullisht për marrjen e informacionit më të detajuar mbi programin dhe thirrjet e tij për propozime.

2.4 Studime të rasteve - me pjesëmarrjen e organizatave të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë ato të Kosovës

- Programi Europa për Qytetarët (Italia, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Polonia, Portugalia, Rumania, Spanja dhe Shqipëria) - Projekti REMEDY <https://www.remedyproject.org/project-outputs>

Zëri nga e kaluara - Duke rikujtuar diversitetin

Për shkak të hendekut në mes të brezave në kuptimin e ngjarjeve historike që kanë të bëjnë me regjimet totalitare, izolimin dhe viktimat e tyre, është e rëndësishme të tërheqim vëmendjen e brezit të ri në këto tema për të eliminuar hendekun e mirëkuptimit. Projekti "REMEDY", u përpoq të krijojë kushte të favorshme për zbulimin dhe përkujtimin e momenteve të dhimbshme në historinë e kombeve të BE-së. Lidhur me objektivat e përgjithshme, qëllimi i REMEDY ishte të promovonte diversitetin e ngjarjeve historike dhe, nga ana tjetër, të nxiste mirëkuptimin e individualitetit të çdo populli. Duke kuptuar perspektivën e secilit vend dhe duke përkujtuar humbjet dhe tragjeditë e njëri-tjetrit, në dritën e identitetit të ri "europian" përfundimisht hendeku në mes të brezave mund të eliminohet, por edhe hendeku kombëtar.

Lidhur me objektivat specifike, "REMEDY" u përqendrua në anën pozitive të historisë, pasi që themelimi i BE-së solli paqe dhe demokraci. Meqë çmimi i paqes ishte shumë i lartë dhe tani është një gjë e brishtë për ta marrë si të mirëqenë, shoqëria e BE-së do të marrë pjesë në reflektimin mbi të kaluarën në mënyrë që të vlerësojë dhe të zhvillojë të tashmen. Prandaj, duke shikuar përsëri në kontekstin më të gjerë historik kombëtar dhe të BE-së të periudhës, qëllimi kryesor i REMEDY ishte promovimi i dialogut pozitiv ndërmjet grupeve të ndryshme të synuara të shoqërisë, përfshirë gjeneratën e vjetër dhe të re. Të kuptuarit se çfarë ka përjetuar brezi i vjetër në një shoqëri shumë të ndryshme, do t'i mundësojë të rinjve të kërkojnë rrugë të reja për të mbrojtur në mënyrë efektive liritë dhe të drejtat civile në komunitetin modern të BE-së.

REMEDY mbështeti prioritetin vjetor të Programit "Europa për Qytetarët" me titull "Izolimi dhe humbja e qytetarisë nën regjimet totalitare", pasi që të gjitha vendet partnere kanë një histori të përbashkët të regjimeve totalitare dhe izolimit që sollën trazira të mëdha në shoqëri. Njerëzit më të prekur ishin pakicat, siç janë romët, komunitetet hebraike, të cilat kanë kaluar nëpër procesin e zhvendosjes, përjashtimit dhe marginalizimit të ashpër. Qëllimi i «REMEDY» ishte përhapja e vetëdijes për çështjet e përmendura më lart, dëgjimi i tregimeve për të kaluarën, edukimi i publikut të gjerë, dhe rinisë rreth pasojave të këtyre ngjarjeve dhe mësimëve që mund të nxjerrim prej tyre. U organizuan 4 ngjarje ndërkombëtare dhe 10 punëtori kombëtare. REMEDY ishte e rëndësishme për arsye të situatës së refugjatëve të kohëve të fundit, gjë që solli rezonancë të madhe, në disa raste edhe frikë dhe paragjykime në BE. Përmes komunikimit dhe reflektimit, është e mundur të luftohet urrejtja dhe të parandalohen pasojat fatale të historisë së kaluar.

Qëllimi kryesor ishte që këto vende të bashkoheshin për të reflektuar mbi shkaqet, përkujtimin e viktimave dhe pajtimin. Mësimet e së kaluarës janë relevante sot për shkak të unitetit dhe faljes, duke u zhvendosur drejt një të ardhmeje më të ndritur të diversitetit dhe vlerave të përbashkëta. "REMEDY" ka depërtuar tek brezat e vjetër dhe të ri rreth çështjes së izolimit, antisemitizmit, armiqtësisë ndaj emigrantëve duke përdorur mjetet e nevojshme për të luftuar këto çështje. Shqipëria solli përvojën e saj të regjimit totalitar si vlerë të shtuar për këtë projekt. Aktivitetet u zbatuan në Shqipëri dhe në qytete të ndryshme të BE-së.

Ndarja e ngjashme e përvojave mund të sigurohet nga OShC-të e Kosovës në partneritet me organizatat rajonale dhe të BE-së. Duke marrë diçka negative nga e kaluara dhe duke e ndarë atë me vendet e tjera që kanë

përjetuar fenomene të ngjashme negative dhe paralelisht duke portretizuar se si shoqëria ka mësuar dhe është zhvilluar tutje është diçka për të cilën OShC-të e Kosovës lehtë mund të kontribuojnë. Megjithatë, partneritetet me organizatat rajonale dhe me seli në BE duhet të krijohen përtej thirrjes për propozime. Këto partneritete do të rezultojnë në projekt propozime që mund të kthehen në aplikacione për programin “BE për qytetarët”.

- **EUROPA Krijuese - Projekti CORNERS**

<http://www.cornersofeurope.org>

Një numër i institucioneve kulturore nga skajet e Europës ndërtojnë një partneritet afatgjatë bazuar në përgjegjësinë e përbashkët. CORNERS u iniciua në vitin 2010 nga gjashtë institucione kulturore: [Intercult](#) (Stokholm), [Exodos](#) (Lubjana), [POGON](#) (Zagreb), [Drugo more](#) (Rijeka), [City Culture Institute](#) (Gdansk), dhe [Umeå 2014](#) – Kryeqyteti European i Kulturës. Më pas, projekti u zhvillua së bashku me disa institucione, partnerë kryesorë dhe bashkëpunëtorë të rinj: [Donostia / San Sebastian 2016](#) - Kryeqyteti European i Kulturës, [Këshilli i Arteve i Irlandës së Veriut](#) (Belfast), [ISIS Arts](#) (Newcastle), [REX](#) (Beograd), [DokuFest](#) (Prizren) dhe [Teatro Pubblico Pugliese](#) (Bari).

“Për të gjithë ne CORNERS ishte një mundësi unike për të sjellë projekte artistike ndërkombëtare në ato vende të Europës që janë jashtë qendrave kulturore, sociale apo ekonomike, për të testuar modelin e ri të prodhimit artistik dhe për t’u përqendruar në audiencë të ndryshme në të gjithë Europën. Megjithëse CORNERS ka përfunduar udhëtimin e saj, shumë pjesë të projektit do të vazhdojnë jetën e tyre individualisht: nëpërmjet ideve që dolën nga procesi, bashkëpunimeve midis artistëve dhe partnerëve, vetë veprave artistike ...”

CORNERS mori përkrahje nga Komisioni European dy herë: së pari për fazën R&D të gjatë një vit e gjysmë, më vonë për një fazë 4 vjeçare të prodhimit dhe prezantimit. BE-ja ka dhënë gjysmën e shumës totale për Corners, e cila është plotësuar me të njëjtën shumë parash nga organizatat e partnerëve.

Organizata të ndryshme i kanë sjellë këtij projekti diçka unike, qoftë në qytetin ku ata veprojnë, qoftë në festivalin që organizojnë, qoftë në një grup të synuar apo në një formë arti që ato aplikojnë. OShC-ja e Kosovës mori pjesë si bashkëpunëtorë. Ky lloj i përvojës duhet të ndahet me OShC-të e tjera. Duhet të zhvillohen ide të reja, të krijohen partneritete dhe të bëhen përgatitje për thirrjet e vitit 2019 në kuadër të këtij programi. Ekzistojnë gjithashtu disa praktika të mira në lidhje me bashkëfinancimin nga fondet e veçanta të Qeverisë dhe për këtë arsye duhet të vendoset kontakti i afërt dhe shkëmbimi i informacionit me zyrën përfaqësuese brenda Ministrisë së Kulturës.

- **HORIZONTI 2020 - Projekti Trajnimi për Paqen**

<https://project.peacetraining.eu/>

Ka kohë që prej kur konfliktet politike kanë shkuar përtej kufijve kombëtarë dhe ndërtimi i paqes është bërë thelbësor për vetë-konceptimin e Bashkimit European si një akter i politikës së jashtme. Aktualisht sfida sa i përket trajnimeve për Parandalimin e Konflikteve dhe Ndërtimin e Paqes (CPPB) është se shumë nga

programet e ofruara janë në të njëjtën kohë shumë të përgjithshme/specifike, si dhe nuk janë mjaftueshëm të zbatueshme, janë të dobëta për zgjerimin e shkathtësive konkrete dhe për më tepër trajnimi si i vetëm nuk është i mjaftueshëm. Tejkalmi i këtyre sfidave kërkon kurrikula të reja trajnimi për CPPB dhe aktivitete të ndërlidhura.

PeaceTraining.eu synon të analizojë këto çështje me përfshirje të fuqishme të të gjithë akterëve relevantë për të marrë parasysh praktikat aktuale dhe për të ofruar metoda të reja të trajnimit për personelin e CPPB. Për të përmbushur këto sfida dhe për të hetuar këtë fushë komplekse të hulumtimit, përdoret qasja e modelimit shumëdimensional.

Modeli rezultues i Kubit, i patentuar nga PeaceTraining.eu, përshkruan strukturat e kurrikulës duke përfshirë palët e interesuara, metodat e reja, strukturat e kurseve, teknikat si dhe aspektet e mëtejshme, e-qasjet, mjetet dhe entitetet.

Platforma e internetit PeaceTraining.eu (www.peacetraining.eu) ka një bazë të njohurive, hartën e palëve të interesit, kërkues të ekspertëve, infografikë, bibliotekën e praktikave më të mira dhe udhëzues digjital për të fuqizuar transferimin e informacionit midis të gjitha zhvillimeve të projektit dhe implementimeve të ardhshme. Përmes projektit ofrohen shërbime instalimi për Kurrikula trajnimi shtesë dhe Mjete të hulumtimit për qendrat e trajnimit dhe trajnerët. Kështu, PeaceTraining.eu për shkak të strategjisë së saj të qëndrueshme me mobilizim afatgjatë dhe aktivitete angazhimi duke përfshirë një Simpozium Ndërkombëtar të PeaceTraining.eu, rrit ndërgjegjësimin/vetëdijen mbi këtë temë dhe gjithashtu tërheq grupet dytësore të synuara duke përfshirë ofruesin e kurseve të trajnimit, institucionet arsimore dhe trajnerët.

Në nivelin evropian, PeaceTraining.eu do të sjellë metoda dhe kurrikula të reja të trajnimit për CPPB dhe do të shërbejë si një burim i vetëm për të rritur efikasitetin dhe për të zvogëluar shpenzimet.

Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë mori pjesë në këtë projekt si organizatë partnere, së bashku me dhjetë partnerë të tjerë të projektit nga BE dhe rajoni. Është gjithashtu një bashkëpunim mes sektorit privat dhe shoqërisë civile, që është karakteristikë e programit HORIZONTI 2020. Ky lloj i qasjes duhet të synohet më tej nga OShC-të e Kosovës, edhe pse ky program i veçantë nuk është caktuar si prioritet nga Qeveria e Kosovës. Lidhur me programet e BE-së, aktivitetet e avokimit duhet të planifikohen nga OShC-të në lidhje me ushtrimin e caktimit të prioritetëve të vitit 2019.

3. Të gjeturat e hulumtimit në terren

Gjatë këtij hulumtimi janë intervistuar gjithsej 8 OJQ të Kosovës. Përveç kësaj, intervistat u zhvilluan me akterë të tjerë të rëndësishëm si Zyra e BE-së në Kosovë dhe projekti aktual i asistencës teknike i financuar nga BE-ja “Mbështetje për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së”.

Temat e diskutuara gjatë intervistave ishin:

- Niveli i njohurive për programet e BE-së në përgjithësi dhe ato që janë të lejuara për Ballkanin Perëndimor në veçanti
- Niveli i njohurive (informimit) për 17 programet e BE-së për të cilat Kosova kualifikohet që nga viti 2017
- Kontaktet me organizatat me seli në BE me qëllim të pjesëmarrjes në këto programe
- Niveli i njohurive për procedurën e nevojshme për të aplikuar në këto programe
- Mbështetje e nevojshme për të qenë në gjendje të absorbojnë fondet e këtyre programeve

Intervistat ishin me pyetje të hapura; prandaj gjetjet mund të elaborohen përtej temave të sipërpërmendura.

3.1 Niveli i njohurive për programet e BE-së në përgjithësi dhe ato që janë të lejuara për Ballkanin Perëndimor në veçanti

Nga 8 organizata të intervistuar, tre prej tyre ishin të vetëdijshme/informuara për programet e BE dhe që Kosova kualifikohet për të marrë pjesë në këto programe. Organizatat që ishin të vetëdijshme/informuara për programet kanë marr pjesë në këto programe më herët përmes konzorciumeve me organizata të BE-së dhe rajonale ose kanë dëgjuar rreth programeve përmes artikujve të lajmeve. Asnjë nga organizatat e intervistuar nuk ka marrë pjesë në sesionet informative të organizuara nga Ministria e Integritimit European apo Zyra e BE-së në Kosovë. Pak organizata konfirmuan se kanë marrë ftesë nga MIE për punëtoritë informuese në lidhje me këto programe, megjithatë, nuk kanë marrë pjesë në punëtori.

Organizatat e intervistuar ishin të informuara për programet IPA (Instrumenti i Shoqërisë Civile) dhe EIDHR të BE-së që janë të dizajnuara për OShC-të dhe për thirrjet për propozime që publikohen rregullisht nën këto programe dhe brenda skemave vjetore të BE-së në Kosovë. OJQ-të e intervistuar kërkuar informatat për ndërlidhjen mes këtyre programeve dhe programeve të tjera të BE-së

3.2 Niveli i njohurive (informimit) për 17 Programet e BE-së për të cilat Kosova kualifikohet që nga viti 2017

Ato OJQ që kishin njohuri për programet e BE-së, gjithashtu ishin të informuara edhe për kualifikimin e fundit të Kosovës përmes MK me BE-në. Sidoqoftë, asnjë nga OJQ-të nuk mundi t'i numëronte të gjitha 17 programet. Europa Krijuese, BE për Qytetarët dhe Horizonti 2020 ishin programet më së shumti të njohura për OJQ-të e intervistuar. Erasmus + gjithashtu, si një vazhdim i Erasmus-it të mëparshëm.

3.3 Kontaktet me organizatat me seli në BE me qëllim të pjesëmarrjes në këto programe

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se ekzistojnë dy lloje të ndryshme të partneriteteve ndërmjet OShC-ve në Kosovë dhe BE.

Partneriteti i bazuar në të ardhura: OJQ-të e Kosovës janë kontaktuar nga organizatat me seli në BE për të marrë pjesë në thirrje të caktuara për propozime. Kontributi i OJQ-ve kosovare në këto konzorciume / partneritete afatshkurtra zakonisht është i natyrës administrative, logjistike dhe organizative.

Nga OJQ-të kosovare nuk kërkohet apo kërkohet rrallë që të kontribuojnë me ekspertizën e tyre në një fushë të caktuar të mbuluar nga thirrja specifike për propozime. Kjo zakonisht mbulohet nga organizatat me seli në BE.

Këto partneritete zakonisht janë afatshkurtra dhe nxiten nga thirrje të caktuara për propozime.

Partneritetet afatgjata: Këto janë më pak në numër (dy raste nga të gjitha organizatat e intervistuar) kanë pasur partneritete afatgjata me organizatat me seli në BE që kanë filluar dhe kanë zgjatur përtej thirrjes specifike për propozime. Këto janë partneritete të bazuara në sektor të veçantë në të cilin OShC-të janë aktive. Shembull i tillë është 7 Arte - OShC me seli në Mitrovicë, duke promovuar aktivizmin dhe kulturën e të rinjve. Kjo organizatë është pjesë e rrjeteve rajonale dhe të BE-së. Ajo më parë ka marrë pjesë në programet ERASMUS dhe Europa Krijuese - përmes këtyre partneriteteve dhe anëtarësimeve në rrjete.

Çështje horizontale në qasjen dhe zbatimin e fondeve të programeve të BE-së që është identifikuar gjatë hulumtimit është liria e lëvizjes/sfidat që lidhen me marrjen e vizave të udhëtimit. Meqenëse këto programe përfshijnë rrjetëzim intensiv me organizatat me seli në BE, çështja e vizave është një pengesë serioze për krijimin dhe mbajtjen e kontakteve dhe marrëdhënieve me OShC-të jashtë Kosovës dhe rajonit të BP-së.

3.4 Niveli i njohurive për procedurën e nevojshme për të aplikuar në këto programe

OJQ-të e Kosovës janë të informuara për procedurat e thirrjeve për propozime të financuara nga BE. Megjithatë, ata nuk janë në dijeni për kërkesat më specifike në lidhje me programet e BE-së dhe thirrjen e tyre për propozime.

Shumica e organizatave të intervistuar preferojnë të kenë aftësi brenda organizatës për të shkruar projekt propozimet dhe për të aplikuar për thirrjet e BE-së. Angazhimi i konsulencës së jashtme për të shkruar propozime për projekte shihet si një ushtrim artificial që zakonisht nuk rezulton me aplikim të suksesshëm. Për më tepër, vizioni dhe objektivat e organizatave nuk portretizohen ose shprehen në aplikacion pasi që nuk shkruhen nga vetë stafi i organizatës. Megjithatë, në një rast, organizata preferonte të angazhonte konsulencë të jashtme për këtë qëllim. Kjo aftësi shihej si mungesë brenda organizatës dhe një aftësi që organizata nuk e shihte si të nevojshme për ta pasur.

Për sa i përket aftësisë operationale, duke përfshirë menaxhimin e duhur financiar dhe mjetet tjera operationale dhe administrative për të cilat organizatat vlerësohen në detaje gjatë procesit të aplikimit, por edhe nga organizatat e mundshme partnere me seli në BE, gjetjet e hulumtimit ndryshojnë nga organizata në organizatë. Organizatat më të mëdha dhe të vendosura nëpër qendra kanë mjetet e nevojshme menaxhuese (operationale dhe administrative) që nevojiten për funksionimin organizativ sipas standardeve të kërkuara. Disa nga OShC-të lokale gjithashtu kanë arritur këtë nivel të kapaciteteve - kryesisht përmes granteve institucionale të financuara nga donatorë të ndryshëm që kanë dhënë mbështetje në këtë drejtim. Disa nga organizatat e intervistuar e gjejnë këtë të jetë ende sfiduese pasi që varen plotësisht nga projektet e financuara nga donatorët për zbatimin e aktiviteteve të tyre, prandaj struktura e brendshme operationale

dhe administrative i është përshtatur nevojave të projekteve të ndryshme. Mungojnë struktura, proceset dhe mjetet e brendshme operacionale dhe administrative të qëndrueshme, stabile dhe efikase. Si shembull konkret, disa organizata përmendën sfidën e financimit të auditimit vjetor për organizatën - përveç auditimeve të fondeve të projekteve. Organizatat nuk kanë fonde për këtë dhe për këtë arsye disa prej tyre kanë mbetur prapa me kontrollet e tyre të auditimit.

Gjatë intervistave u përmend se grantet institucionale të financuara nga donatorët kanë ndihmuar jashtëzakonisht OJQ-të në ristrukturimin e tyre dhe gjithashtu në zhvillimin e tyre strategjik. Disa nga organizatat e intervistuar që kanë marrë një grant institucional kanë zhvilluar strategjitë e tyre, kanë zhvilluar strukturën, procedurat dhe rregulloret e burimeve njerëzore. Kjo shihet si një hap përpara në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm dhe rritjes së konkurrencës së OShC-ve të Kosovës në nivel rajonal dhe të BE-së.

3.5 Ndarja e informacionit / promovimi i programeve të BE-së nga BE dhe Ministria e Integritit European

Zyra e BE-së në Kosovë dhe Ministria e Integritit European (MIE) kanë organizuar sesione fillestare informuese mbi kualifikimin e Kosovës për programet e BE-së. Ata kanë publikuar informata kyçe mbi programet relevante të BE-së pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë. Deri në gusht të vitit 2018 - kur u realizua hulumtimi, marrëveshjet bilaterale midis BE-së dhe Kosovës për katër (4) programe të BE-së nuk ishin finalizuar, duke përfshirë procedurat e brendshme të miratimit/ratifikimit nga institucionet e Kosovës. Për shkak të zgjatjes së procesit të miratimit në Kuvendin e Kosovës, BE dhe MIE nuk kanë filluar me ofrimin e mëtejshëm të informacionit për programet specifike dhe procedurat e aplikimit.

OJQ-të e intervistuar shfaqën njohuri të kufizuara për programet e BE-së. Gjatë intervistave është pranuar se OJQ-të gjithashtu treguan pak interesim për këto programe në kërkimin e informacionit nga institucionet e lartpërmendura.

Megjithatë, ka nisma të kohëve të fundit të ndërmarra nga shoqëria civile për të rritur nivelin e njohurive mbi programet e BE-së, me fokus të veçantë në ato që janë tërheqëse për OShC-të. Një nismë e tillë është ndërmarrë nga Dokufest dhe quhet "Creative Kosovo". "Creative Kosovo" është një iniciativë e DokuFest që synon të zhvillojë Rrjetin European dhe Rajonal të Partneritetit Kulturor dhe ngritjen e kapaciteteve të sektorit kulturor dhe krijues në Kosovë në përgatitje për anëtarësim në aplikimet e programit "Creative Europe"⁷. Qëllimi i tij është të ngris kapacitetet e organizatave dhe individëve nga sektori kulturor dhe krijues për t'u përgjigjur në mënyrë cilësore në adresimin e prioriteteve dhe veprimeve të vendosura në Programin e punës vjetore të Europës Krijuese.

⁷ <http://dokufest.com/creative-kosova-industry-events-dokufest/>

4. Konkluzionet dhe rekomandimet

4.1 Mungesa e njohurive për programet e BE-së

4.1.1 Konkluzionet

Hulumtimi ka gjetur se në përgjithësi ka mungesë njohurish mes OShC-ve për programet e BE-së. Në të vërtetë, u identifikuan disa njohuri për programet specifike, por mungojnë njohuritë më të thella për prioritetet e këtyre programeve.

Për më tepër, ndarja e informacionit për këto programe nga BE dhe nga institucionet qeveritare përgjegjëse është e pamjaftueshme. Platformat si CIVIKOS apo rrjetet e OShC-ve të Kosovës nuk janë shfrytëzuar për këtë qëllim. Megjithatë u identifikuan disa përpjekje për ndarjen e informacionit (morën ftesa për takim/punëtori/mbledhje informuese), hulumtimi ka gjetur se nuk ka pasur përpjekje të mëtijshme për të rritur nivelin e njohurive mbi programet e BE-së në mesin e OShC-ve. Ngjashëm, mungon qasja proaktive në drejtim të marrjes së informacionit mbi programet e BE-së nga ana e OShC-ve. Numër i kufizuar i OShC-ve është i informuar për programet, pothuajse asnjë nga OShC-të nuk mund të listojë të gjitha programet e BE-së dhe vetëm pak janë të informuara për ato programe ku OShC-të kanë të drejtë të aplikojnë.

4.1.2 Rekomandimet

a) Ndarja e informacionit nga BE dhe institucionet qeveritare

Zyra e BE-së në Kosovë aktualisht menaxhon një projekt që është në vazhdim e sipër të asistencës teknike "Mbështetje për Pjesëmarrjen e Kosovës në Programet e BE-së", që synon të mbështesë Kosovën në qasjen më të mirë në programet e BE-së. Ky lloj i mbështetjes do të vazhdojë edhe në vitin 2019. Kjo AT duhet të parashikojë dialog dhe konsultime më intensive me OShC-të në mënyrë që të promovojë qasjen gjithëpërfshirëse kur të diskutohen prioritetet e Kosovës në krahasim me programet e BE.

Ministria e Integritit European duhet të zhvillojë një plan veprimi në lidhje me programet e BE-së dhe ndarjen e informacionit në këtë drejtim. Zyrat përfaqësuese në institucionet përkatëse që do të merren drejtpërdrejt me këto programe duhet të bëhen plotësisht funksionale dhe të komunikojnë me OShC-të për prioritetet afatshkurtra dhe afatgjata. Zyra e Europës Krijuese në kuadër të Ministrisë së Kulturës do të përfitojë nga Dokufest një bazë të dhënash të organizatave kulturore në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kjo bazë e të dhënave duhet të përdoret për shkëmbimin e mëtijshëm të informacionit për programin Europa Krijuese dhe për krijimin e partneriteteve dhe iniciativave të mundshme. Kjo qasje mund të përdoret për programe të tjera, si dhe të ekzistoj një zyrë përfaqësuese për çdo program.

b) Roli avokues i OJQ-ve

OShC-të duhet të bëhen më të zëshme kur kërkojnë informacion në lidhje me programet e BE-së. Deri më sot, ka pasur një qasje pasive drejt kërkimit dhe marrjes së informacionit mbi programet e BE-së. Organizatat që janë aktive në procesin e integritit në BE mund të zhvillojnë mjete për shkëmbimin e informacionit që mund t'u shpërndahen OShC-ve të interesuara. Duhet të bëhet presion në zyrat përfaqësuese të programeve si dhe në Zyrën e BE-së në Kosovë për ndarjen më intensive të informacionit. Presion i njëjtë duhet bërë për të përfshirë në mënyrë aktive OShC-të në konsultime për caktimin e prioritetëve për raundin e ardhshëm të programeve në vitin 2019.

Për më tepër, meqenëse nën-programi për media i Europës Krijuese nuk është i arritshëm për OShC-të e Kosovës dhe pasi që duhet hartuar legjislacioni i ri, roli avokues i OShC-ve, por edhe ekspertiza e tyre, mund të kontribuojnë në masë të madhe në këtë proces.

Ndarja e informacionit duhet të fillojë menjëherë dhe atë për katër programet për të cilat Kosova ka nënshkruar MN-të. Ka thirrje për propozime që do të shpallen deri në fund të vitit 2018 për të cilat OShC-të e Kosovës mund të aplikojnë. Fokusi duhet t'i kushtohet jo vetëm programeve specifike, por edhe fushave specifike prioritare brenda programeve për të cilat do të jenë të interesuara OShC-të e Kosovës. Disa nga mjetet e dobishme që do të mund të përdoren janë:

- *Fletëpalosjet* - që përmbajnë informacion të shkurtër për secilin program, fushat kryesore me prioritet dhe objektivat e saja, faqen e internetit ku mund të gjenden më shumë informata të detajuara, nëse ekziston një MN mes Kosovës dhe BE-së për një program të tillë, detajet e kontaktit të zyrës përfaqësuese duhet të renditen gjithashtu.
- *Sesionet informuese*: këto seanca mund të organizohen në formatin e punëtorive. Përveç ofrimit të një prezantimi mbi programet e BE-së - me fokus të veçantë në 4 për të cilat MN-të janë të nënshkruara, këto seanca duhet të përfshijnë shembuj nga OJQ-të që kanë marrë pjesë tashmë në këto programe (Dokufest, 7 Arte, KEC etj.). Këto OJQ mund të shpjegojnë të gjithë procesin nga krijimi i partneriteteve me organizatat me seli në BE, aplikimin dhe zbatimin. Të dyja, përparësitë dhe sfidat mund të diskutohen në detaje. Në këtë mënyrë, OJQ-të tjera mund të marrin informacion të dorës së parë për këto programe dhe procese që janë të përfshira në qasjen e fondve të tyre.
- *Ndarja e informacionit për thirrjet për propozime të ardhshme dhe në vazhdimësi* në kuadër të programeve të BE-së ku OShC-të e Kosovës mund të aplikojnë: për këtë duhet identifikuar një OJQ kyqe që do të jetë në gjendje të ndajë këtë informacion. Për më tepër, OJQ-të mund të avokojnë që zyrat përfaqësuese të programeve të caktuara të ndajnë këtë informacion rregullisht. Platforma CIVIKOS mund të përdoret në mënyrë efektive edhe për këto qëllime.

4.2 Mundësitë dhe sfidat për qasje në programet e BE-së

4.2.1 Konkluzionet

Qasja në fondet e programeve të BE shihet si sfiduese nga shumica e OShC-ve në Kosovë. Sfidat kanë dimensione të ndryshme varësisht nëse OShC-të janë qendrore apo lokale.

Sfida kryesore për OSHC-të qendrore është mungesa e ekspertizës sektoriale dhe vlera e shtuar e OShC-ve të Kosovës në objektivat e përgjithshme të programeve të BE-së dhe prioritetëve të tyre specifike. Ekziston një tendencë që OShC-të e Kosovës të përfshihen nga partnerët ndërkombëtarë më shumë për veprimtaritë logjistike, administrative dhe aktivitete të vogla, dhe jo për një kontribut thelbësor në objektivin e përgjithshëm të veprimit. Pas pothuajse dy dekadave të zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë, ekziston nevoja që tu jepet një rol i madh në partneritetet ndërkombëtare që do t'u mundësonte OShC-ve të Kosovës të sjellin një vlerë të shtuar me përvojën dhe ekspertizën e tyre. Mirëpo, ka gjithashtu raste që përmes anëtarësimit të tyre në rrjetet rajonale dhe europiane, ato me të vërtetë kanë sjell një vlerë të shtuar. Kjo është kryesisht për shkak se organizatat kanë një fokus të veçantë në punën e tyre dhe kjo ka lehtësuar partneritetet e tyre me organizatat ndërkombëtare.

Për OShC-të lokale sfida më e madhe po bëhet e dukshme përtej kufijve të Kosovës, duke filluar në nivelin rajonal dhe duke vazhduar në nivelin europian. Aktualisht, OShC-të lokale përballen me vështirësi në zgjerimin e tyre përtej komunës së tyre. Ato konkurrojnë me OShC-të e mëdha në Kosovë që janë të vendosura në qendër. Ka raste të partneriteteve të suksesshme me OShC-të më të mëdha në Kosovë që u kanë mundësuar qasje në fonde më të mëdha nga donatorë të ndryshëm dhe kanë kontribuar në forcimin e organizatave më të vogla. Kjo qasje shihet si e përshtatshme në synimin për programet e BE-së.

Një sfidë e përbashkët e identifikuar nga të gjitha OShC-të është bashkëfinancimi i kërkuar në thirrjet për propozime të programeve të BE-së.

4.1.2 Rekomandimet

OShC-të e Kosovës janë zhvilluar dukshëm gjatë 18 viteve të fundit. Tani ekziston një ndarje sektoriale ku OShC-të kanë provuar të jenë akterë i rëndësishëm dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës. Kjo është një forcë për të cilën shumë OShC nuk janë plotësisht të vetëdijshme. Kjo është edhe vlera e tyre e shtuar që mund të sjellin në partneritetet rajonale dhe ndërkombëtare që mund t'ua hap derën drejt programeve të BE. OShC-të duhet të identifikojnë pikat e tyre të forta bazuar në përvojën e tyre dhe t'i çojnë tutje drejt rritjes së specializimit të tyre për prioritetet specifike sektoriale/tematike/strategjike. Kjo do të shërbejë për zhvillimin dhe arritjen e partneriteteve me organizatat me seli në BE. Rrjetëzimi i bazuar në sektor midis OShC-ve është gjithashtu i këshillueshëm.

Asistenca e financuar nga donatorët e cila veq se ekziston, mund të mbështesë proceset e përmendura më lart. Asistenca teknike aktuale dhe e cila po vazhdon, e financuar nga BE dhe ajo e planifikuar për vitin 2019 mund të lehtësojnë kontaktet dhe partneritetet e mundshme ndërmjet OShC-ve të Kosovës dhe BE-së. Donatorë të ndryshëm kanë financuar nisma të ndryshme përmes të cilave OJQ-të e Kosovës janë dërguar në vendet fqinje ose në shtetet anëtare të BE-së për t'u takuar me OShC-të ose rrjetet më të mëdha. Kjo është bërë me qëllimin për të pasur përvojën e praktikave më të mira, për qëllime mësimore ose të shkëmbimit të informacionit. Një qasje e re me qëllim të ngjashëm mund të lehtësojë qasjen e OShC-ve të Kosovës në programet e BE-së. OShC-të dhe rrjetet me seli në BE mund të sillen në Kosovë dhe të takohen me homologët e tyre. Takimet mund të organizohen me ndarje sektoriale. Vizitat mund të organizohen në tërë Kosovën. Qëllimi përfundimtar do të jetë krijimi i kontakteve dhe partneriteteve afatgjata që do të rezultojnë në programe dhe aktivitete/projekte të përbashkëta. Sa i përket bashkëfinancimit, iniciativa e IRJM-së mund të përdoret si një praktikë e mirë në këtë rast. Ministria e Kulturës ka ndarë një fond specifik për bashkëfinancimin e iniciativave që financohen nga programi Europa Krijuese. Pasi që 90% e tarifës hyrëse të institucioneve të Kosovës për programet e BE-së do të mbulohet përmes ndihmës së IPA-s, shuma të ngjashme të fondeve mund të përdoren nga zyrat përfaqësuese për financimin e bashkëfinancimit për aplikimet e suksesshme të OShC-ve të Kosovës në kuadër të programeve relevante të BE-së. Kjo çështje duhet të diskutohet më tej me zyrat përfaqësuese përkatëse.

4.3 Përkrahja/ngritja e kapaciteteve për OShC-të për të lehtësuar qasjen në programet e BE-së

4.3.1 Konkluzionet

Të gjitha OShC-të e intervistuarat kanë kërkuar mbështetje në lidhje me programet e BE-së. Kjo nevojë për mbështetje është kryesisht për shkak të mungesës së njohurive më të thella për këto programe.

Edhe pse shumica e OShC-ve tashmë po zbatojnë qasje dhe aktivitetete inovative, kur bëhet fjalë për hartimin e projekt propozimeve të mira, ekziston mungesa e fokusit dhe teknikës së duhur. Për më tepër, ka shpesh shprehje midis vizionit dhe misionit të organizatës dhe projekt propozimeve të reja. Në disa raste, aplikimi dhe procedurat që shoqërojnë procesin e aplikimit janë shumë sfiduese. Prandaj, në këto raste organizata shpesh vendos për zgjedhjen e konsulentit të jashtëm për të shkruar propozimin e projektit.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se ekziston një lodhje e dukshme nga sesionet informative njëditore ose trajnime ku një ekspert jap mësim rreth projekt propozimeve, kornizës logjike, objektivave, rezultateve dhe aktiviteteteve. Duke qenë zakonisht aktivitet njëditor, kjo nuk siguron qëndrueshmëri. Për më tepër, shumë shpesh këto punëtori nuk janë të lidhura me ndonjë thirrje të veçantë dhe nuk ka përcjellje pasuese/vazhdimësi të këtyre sesioneve njëditore.

Në të gjitha thirrjet për propozime të programeve të BE-së, aplikantëve, bashkë-aplikantëve dhe subjekteve tjera u kërkohet të kenë një nivel të caktuar të përvojës, si dhe kapacitete financiare dhe operationale. Kjo është me të vërtetë një sfidë për OShC-të me kapacitete më të dobëta, ndonëse edhe OShC-të më të forta kërkojnë mbështetje në krijimin e sistemeve të shëndosha të menaxhimit financiar brenda organizatës së tyre si dhe strukturës së qëndrueshme organizative.

4.3.2 Rekomandimet

Ekziston nevoja e qartë për zhvillimin e programeve të ngritjes së kapaciteteve që do të mbështesin OShC-të për qasje në programet e BE-së. Këto programe për ngritjen e kapaciteteve duhet të integrohen me aktivitetet e ngritjes së njohurive të përmendura më lart, si p.sh. sesionet informative, si dhe lehtësimin e partneriteteve të reja. Në vijim janë dhënë disa nga llojet e programeve të ngritjes së kapaciteteve:

a) Programi i ngritjes së kapaciteteve që lidhet me fushën e veprimit

Çdo program i BE-së ka nën-programe specifike dhe fusha me prioritet. Programet e ngritjes së kapaciteteve duhet të synohen në bazë të këtyre sektorëve dhe fushave me prioritet. Siç u përmend më parë, këto programe duhet të përfshijnë studime të rasteve nga aktivitetet ku OJQ-të e Kosovës kanë marrë pjesë tashmë. Një shembull i mirë i një iniciative të tillë është organizuar nga Dokufest gjatë gushtit të vitit 2018. Ekziston një seri e punëtorive në lidhje me programin Europa Krijuese të BE-së. Punëtoritë përfshijnë OShC-të e ndryshme nga rajoni, zyrat përfaqësuese; dhe diskutohen praktikatat më të mira si dhe rruga përpara për Kosovën që të kualifikohet për më shumë fusha me prioritet të këtij programi⁸.

b) Udhëzimi-mentorimi ("coaching") dhe shembujt e praktikës së mirë - të mësuarit nga përvoja reale

Studimet e rasteve janë një nga mjetet më të mira për të ndarë përvojën e vërtetë që mund të përdoret nga të tjerët. Në Kosovë, ka disa OShC që kanë marrë pjesë në programet e BE-së në modalitete dhe role të ndryshme (Dokufest, Teatri ODA, 7 Arte, KCSS). Këto organizata dhe përfaqësuesit e tyre mund të përdoren si trajnerë/mentor që japin informacion të detajuar mbi përvojën e tyre në aplikimin për programet e BE-së dhe zbatimin e tyre.

⁸ <http://dokufest.com/creative-kosova-industry-events-dokufest/>

Përveç studimeve të rasteve, udhëzimi/mentorimi si një metodë e ngritjes së kapaciteteve është më i preferuar sesa qasja klasike në klasë. Siç u përmend në seksionet e mëparshme, në mesin e OJQ-ve është identifikuar lodhje nga punëtoritë një-ditore . Udhëzimi/mentorimi dhe mbështetja afatgjate është formati i preferuar dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë planifikimit të iniciativave të ardhshme të mbështetjes.

c) Procesi lidhur me programet e ngritjes së kapaciteteve

Këto programe të ngritjes së kapaciteteve mund të kombinohen me dy programet e mëparshme. Programet për ngritjen e kapaciteteve duhet të lidhen me procese specifike në mënyrë që të kenë rezultate të dukshme. Proceset e tilla janë thirrja për propozime, nënshkrimi i marrëveshjeve të reja ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së, çdo ndryshim që ndodh në programet relevante ose rregulloret e tyre dhe të ngjashme. Kjo do të rris rëndësinë e programeve për ngritjen e kapaciteteve dhe do t'i bëjë ato më tërheqëse për OShC-të. Programi më i hershëm i ngritjes së kapaciteteve mund të parashihet për "BE për Qytetarët", pasi që MN është ratifikuar për këtë program dhe thirrje për propozime është ende e hapur për pjesëmarrjen e OShC-ve. Është thelbësore që programet për ngritjen e kapaciteteve të synojnë OShC-të në tërë Kosovën dhe jo vetëm ato me seli në Prishtinë. Për më tepër, duhet të synohet përpjekja e përbashkët me institucionet qeveritare, institutet hulumtuese, universitetet dhe sektorin privat. Siç tregohet gjatë gjithë hulumtimit, shoqëria civile është sektor diagonal midis programeve të BE-së dhe kjo ofron një mundësi dhe një sfidë për OShC-të.

d) Përdorimi më i mirë i qendrave të informacionit- Resource Center

Ekzistojnë qendra të ndryshme të informacionit në dispozicion në Kosovë dhe në rajon, të cilat mund të konsiderohen si mundësi e mirë për ngritjen e kapaciteteve. Disa prej tyre janë: Qendra Informative e BE-së, Qendra KCSF, platforma rajonale ERASMUS dhe të ngjashme. Platformat e ndryshme të OShC-ve (si CIVIKOS dhe të ngjashme), sapo të njoftohen për një ngjarje apo takim, ata do të përhapin dhe shpërndajnë informacionin. Kjo përfshin iniciativa të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve.

Burimet dhe bibliografia

1) Rregullorja (EU) Nr.1286/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për krijimin e programit të veprimit për përmirësimin e funksionimit të sistemeve tatimore në Bashkimin Europian për periudhën 2014-2020 (Fiscalis 2020) dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 1482/2007/EC (OJ EU L 347, 20.12.2013, f.25).

2) Rregullorja (EU) Nr. 1294/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për krijimin e programit të veprimit për doganat në Bashkimin Europian për periudhën 2014-2020 (Dogana 2020) dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 624/2007/EC (OJ EU L 347, 20.12.2013, f. 209).

3) Rregullorja (EU) Nr. 250/2014 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 për krijimin e programit për promovimin e aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të Bashkimit Europian (programi Hercule III) dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 804/2004/EC (OJ EU L 84, 20.3.2014, f.6).

4) Rregullorja (EU) Nr. 1382/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 17 dhjetor 2013 për krijimin e Programit të Drejtësisë për periudhën 2014-2020 (OJ EU L 354, 28.12.2013, f. 73).

5) Rregullorja (EU) Nr. 1381/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 17 dhjetor 2013 për krijimin e Programit për Drejta, Barazi dhe Shtetësi për periudhën 2014-2020 (OJ EU L 354, 28.12.2013, f. 62).

6) Rregullorja e Këshillit (EU) Nr. 390/2014 e datës 14 prill 2014 për krijimin e programit “Europa për qytetarët” për periudhën 2014-2020 (OJ EU L 115, 17.4.2014, f.3).

7) Vendimi Nr. 1313/2013/EU i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 17 dhjetor 2013 mbi Mekanizëm e Mbrojtjes Civile të BE-së (OJ EU L 347, 20.12.2013, f. 924).

8) Vendimi (EU) 2015/2240 i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 25 nëntor 2015 për krijimin e programit për zgjidhjet e ndërveprimit dhe kornizat e përbashkëta për administratat publike, bizneset dhe qytetarët Europian (programi ISA2) si një mjet për modernizimin e sektorit publik (OJ EU L 318, 4.12.2015, f. 1).

12) Rregullorja (EU) Nr. 1287/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për krijimin e programit për aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020) dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 1639/2006/EC (OJ EU L 347, 20.12.2013, f.33).

10) Rregullorja (EU) Nr. 1296/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 mbi Programin e Bashkimit Europian për Punësim dhe Inovacion Social (‘EaSI’) dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 283/2010/BE për krijimin e Instrumentit të Mikrofinancave për Progresin Europian për punësim dhe përfshirje sociale (OJ EU L 347, 20.12.2013, f. 238).

11) Rregullorja (EU) Nr. 1288/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 që krijon ‘Erasmus +’: Programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin dhe shfuqizimin e Vendimeve Nr. 1719/2006/EC, Nr. 1720/2006/EC dhe Nr. 1298/2008/EC (OJ EU L 347, 20.12.2013, f. 50)

12) Rregullorja (EU) Nr. 1295/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për krijimin e Programit Europa Krijuese (2014-2020) dhe shfuqizimin e Vendimeve Nr. 1718/2006/EC, Nr. 1855/2006/EC dhe Nr. 1041/2009/EC (OJ EU L 347,20.12.2013, f. 221).

13) Rregullorja (EU) Nr. 1291/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për krijimin e Horizontit 2020 - Programi Kornizë për Hulumtim dhe Inovacion (2014-2020) dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 1982/2006/EC (OJ EU L 347,20.12.2013, f. 104).

- Programi 'Shëndeti për Rritje' (1)
- Programi i Konsumatorit (2)
- LIFE (3)
- Koperniku (4)

14) MARRËVESHJA KORNIZË ndërmjet Bashkimit Europian dhe Kosovës* mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së

15) Mbështetje për pjesëmarrje në programet e BE-së, Dokumenti i Veprimit IPA 2017

16) Vlerësimi paraprak për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së 2014-2020, Instrumenti për Përgatitjen e Projekteve për Ministrinë e Integritimit Europian, Kosovë, Europe Aid/137475/DH/SER/XK

17) Udhëzuesi i Programit BE për Qytetarët 2018

18) Programi i Tretë Shëndetësor i BE-së (2014-2020), Grantet e Projektit (HP-PJ-2018), Udhëzues për Aplikantët



Publikuar nga:

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)
www.kcsfoundation.org

Autor: Edis Agani

Kontribuan: Bardha Tahiri

Ky publikim është përkrahur financiarisht nga Sida. Përmbajtja e këtij publikimi është në tërësi përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdomërisht qëndrimet e Sida-s. Të drejtat e rezervuara © 2018. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) Nëntor 2018



Programet e BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile

Përkrahur nga:

